

E

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK/REG/2005/48
21 nëntor 2005

RREGULLORE NR. 2005/48

**MBI RIORGANIZIMIN DHE LIKUIDIMIN E NDËRMARRJEVE DHE
PASURISË SË TYRE ME AUTORIZIMIN ADMINISTRATIV TË
AGJENCISË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në pajtim me nenin 8.1 (q) dhe (r) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001) dhe pas konsultimit të anëtarëve të Këshillit ekonomik e fiskal dhe të Qeverisë,

Pas shpalljes së Rregullore së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2002/12 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut 2001/6 të datës 8 shkurt 2001 mbi organizatat e biznesit,

Duke ditur dispozitën e Rregullore së UNMIK-ut 2003/13 të datës 9 maj 2003 për kalimin e të drejtës së shfrytëzimit në pronën e paluajtshme shoqërore, që lidhet me likuidimin e ndërmarrjeve dhe të drejtën e punëtorëve në procesin e likuidimit,

Me qëllim të riorganizimit për të kthyer qëndrueshmërinë e biznesit apo të ndërmarrjeve që janë duke u likuiduar dhe pasurisë së tyre me autorizimin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, të cilat janë jolikuide ose të mbingarkuara me borxhe, në interes të kreditorëve të tyre, të pronarëve dhe të palëve të tjera të interesuara dhe në dobi të ekonomisë së Kosovës,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

PJESA I
FUSHA DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Fusha

1.1 Me këtë Rregullore caktohen procedurat për riorganizimin ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre, që aktualisht janë nën autorizimin administrativ dhe menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe nuk zbatohet për ndërmarrjet publike

1.2 Procedurat e riorganizimit apo të likuidimit lidhur me ndërmarrjet apo pasuritë e tilla zbatohen për ato që ndodhen në Kosovë. Çfarëdo procedure e riorganizimit apo e likuidimit e zbatuar jashtë Kosovës, nuk do të ketë ndikim në ndërmarrjet apo pasuritë që ndodhen në Kosovë.

Neni 2
Përkufizimet

2.1 Në këtë Rregullore:

“Administrator” do të thotë personi i caktuar nga gjykata sipas kësaj Rregulloreje për të shërbyer si administrator i një ndërmarrje.

“Agjenci” do të thotë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit e themeluar me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut 2002/12 të datës 13 qershor 2002.

“Dispozitat për shpallje dhe njoftime” do të thotë dispozitat lidhur me shpalljet në nenin 49 të kësaj Rregulloreje.

“Plan alternativ i riorganizimit” do të thotë plani alternativ i riorganizimit i dorëzuar nga kreditori i përshtatshëm në pajtim me nenin 21.

“Datë e emërimit” do të thotë data e emërimit të administratorit nga gjykata.

“Ligji në fuqi” do të thotë ligji në fuqi në Kosovë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59 me të cilën është ndryshuar Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 mbi ligjin në fuqi në Kosovë.

“Njoftim mbi emërimin” do të thotë njoftimi i shpallur në pajtim me nenin 17.

“Ditë biznesi” do të thotë një ditë e javës në të cilën institucionet e UNMIK-ut janë të hapura për biznes në Prishtinë, Kosovë, duke përjashtuar të shtunat, të dielat dhe festat e UNMIK-ut në Kosovë.

“Data e fundit për dorëzimin e kërkesës” do të thotë data e përcaktuar në nenin 30.2 (a).

“Plan i vërtetuar i riorganizimit” do të thotë plani i riorganizimit ose plani alternativ i riorganizimit i vërtetuar nga gjykata, në pajtim me nenin 28.

“Korporatë” do të thotë korporata e themeluar nga apo në emër të Agjencisë në pajtim me Rregulloren e AKM-së.

“Gjykatë” do të thotë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Rregullorja për Dhomën e Posaçme).

“Komisioni i kreditorëve” do të thotë Komisioni i kreditorëve i themeluar në pajtim me nenin 19.

“Ndërmarrje” do të thotë çdo subjekt ose pasuri të cilën Agjencia ka autorizim ta administrojë në pajtim me nenin 5 të Rregulloreve të AKM-së, me përjashtim të ndërmarrjeve publike.

“Mbledhja e parë e kreditorëve” do të thotë mbledhja e kreditorëve në pajtim me nenin 23.

“Rregullore e AKM-së” do të thotë Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut 2002/12 e datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

“Tokë e dhënë me qira” do të thotë e drejta në pronë ashtu siç është përshkruar në Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut 2003/13 të datës 9 maj 2003 mbi kalimin e të drejtës në pronën shoqërore.

“Komision për likuidim” do të thotë komisioni i caktuar për drejtimin e procedurës së likuidimit, në pajtim me nenin 43.

“Menaxher ose menaxhment” do të thotë zyrtari kryesor ekzekutiv apo zyrtarët për një periudhë të caktuar të ndërmarrjeve.

“Vendim për moratorium” do të thotë vendim i gjykatës për të pranuar kërkesën për riorganizim të ndërmarrjes, në pajtim me nenin 4.4.

“Zyrtar” do të thotë cilido zyrtar kryesor ekzekutiv i një ndërmarrjeje në një kohë të caktuar.

“Person” do të thotë individi, subjekti ligjor apo publik duke përfshirë edhe korporatën, shoqërinë, pasurinë e besuar, organizatën e painkorporuar, ndonjë qeveri ose agjenci apo nënndarje të saj.

“IPVQ” do të thotë institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes të themeluara sipas Rregulloreve të UNMIK-ut 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë.

“Dëshmi e kërkesës” do të thotë kërkesa dhe informacioni për kërkesën e tillë të dorëzuar nga kreditori në të cilën i paraqet detajet, në pajtim me nenin 17.2.

“Kreditorë të kualifikuar“ do të thotë kreditorët, të cilët individualisht apo kolektivisht mund të dorëzojnë planin alternativ të riorganizimit ashtu siç parashihet në nenin 17.1.

“Kreditor i regjistruar” do të thotë kreditori, i cili e ka dorëzuar dëshminë e kërkesës që në mënyrë të arsyeshme është pranuar nga administratori, në pajtim me nenin 24.1.

“Riorganizim” do të thotë ristrukturimi profesional i ndërmarrjes dhe i operatorëve të saj të biznesit sipas kësaj Rregulloreje, me qëllim të kthimit të qëndrueshmërisë në veprimet e biznesit, i cili mundëson shlyerjen e detyrimeve kontraktuese dhe monetare të ndërmarrjes që është dashur të paguhet dhe nuk janë paguar.

“Kërkesë e siguruar” do të thotë çdo kërkesë në pajtim me nenin 34 për të cilën ndërmarrja i ka ofruar siguri kreditorit.

“Ofrues i shërbimeve “do të thotë individi apo subjekti i angazhuar për t’i ofruar shërbime profesionale administratorit, në pajtim me nenin 7.1.

PJESA II

FILLIMI I RIORGANIZIMIT DHE I MORATORIUMIT

Neni 3

Kërkesa për riorganizimin e një ndërmarrje

3.1 Agjencia mund të fillojë procedurën e riorganizimit për ndërmarrjen e cila është e paaftë që të përmbushë detyrimet që duhet paguar për një periudhë më se gjashtëmuajore, ose ka borxhe në shumën që e kalon vlerën e pasurisë së saj, nëse Agjencia konsideron se ndërmarrja mund të vazhdojë aktivitetet e saj afariste në mënyrë të lëvërdishme tregtare si rezultat i riorganizimit.

3.2 Agjencia e fillon procedurën e riorganizimit duke bërë kërkesë me shkrim në gjykatë në formën e përshkruar në shtojcën e kësaj Rregulloreje dhe duke i bashkëngjitur si në vijim:

(i) dëshmi dokumentare ku tregon se ndërmarrja është e paaftë për t’i përmbushur detyrimet që duhet t’i përmbushë ose ka borxhe që kalojnë vlerën e pasurisë së saj;

(ii) në rastin kur ndërmarrja paraqet kërkesë, dëshmi dokumentare ku tregohet pëlqimi i Agjencisë për atë kërkesë;

(III) një apo më shumë propozime nga Agjencia për caktimin e administratorit, i cili do të ofrojë planin për riorganizimin e ndërmarrjes (plani i riorganizimit).

3.3 Gjykata konsideron se ndërmarrja është e paaftë që t’i përmbushë detyrimet që është dashur t’i përmbushë nëse detyrimet në shumën prej 50.000 € (pesëdhjetë mijë eurove) apo më shumë mbesin të papaguara për më shumë se gjashtë muaj,

pavarësisht se gjatë asaj periudhe disa detyrime janë përmbushur, janë zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër apo janë shlyer nga ndërmarrja ose në emër të saj.

Neni 4

Procedura e riorganizimit e ndërmarrë nga gjykata

4.1 Gjykata e regjistron kërkesën për riorganizim pas pranimit të saj, pavarësisht nga mangësitë në kërkesë apo në dokumentet përcjellëse, e shënon kohën dhe datën e pranimit në faqen e kërkesës dhe menjëherë i dërgon vërtetim regjistrimi Agjencisë dhe ndërmarrjes në fjalë.

4.2 Nëse kërkesa nuk është në përputhje me kërkesat në nenin 3, gjykata lëshon urdhër brenda pesë (5) ditëve të punës nga dita kur kërkesa është dorëzuar në gjykatë, duke i përcaktuar mangësitë dhe duke kërkuar nga Agjencia që ato t'i korrigjojë brenda një periudhe të caktuar kohore nga dita kur urdhri i tillë i dorëzohet Agjencisë. Nëse gjykata nuk lëshon urdhër të tillë brenda pesë (5) ditëve të punës nga dita kur kërkesa është pranuar nga gjykata, kërkesa konsiderohet se nuk ka mangësi dhe pranohet nga gjykata.

4.3 Gjykata e refuzon kërkesën me anë të vendimit të cilin ia dërgon Agjencisë dhe ndërmarrjes në fjalë nëse Agjencia nuk i bën korrigjimet e mangësive brenda kohës së caktuar me urdhër apo nëse kërkesa nuk i plotëson kushtet e nenit 3.

4.4 Nëse Agjencia i ka korrigjuar mangësitë ashtu siç është urdhëruar nga gjykata apo nëse nuk është dhënë urdhër për korrigjimin e mangësive brenda kohës së caktuar, gjykata merr vendim për pranimin e kërkesës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës siç parashihet në pajtim me nënnenin 4.2 lart dhe këtë vendim ia dërgon menjëherë Agjencisë dhe ndërmarrjes (vendimi i moratoriumit).

Neni 5

Moratoriumi

5.1 Nga dita e vendimit për moratorium të gjitha veprimet, procedurat apo aktet e çdo lloji që synojnë zbatimin apo përmbushjen e ndonjë kërkesë ndaj ndërmarrjes në fjalë apo pasurisë së saj do të pezullohen dhe do të vazhdojnë vetëm me lejen e gjykatës.

(a) Veprimet, procedurat apo aktet e tilla të pezulluara përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në:

(i) cilindo akt apo vendim, duke përfshirë procedurat gjyqësore apo vendimet për mbledhjen, kthimin a zbatimin e kërkesave për borxhet, taksat, dënimet apo detyrimet e çfarëdo lloji;

(ii) cilindo akt për të krijuar, për të ndryshuar, për të përforcuar, për të përsosur, për të regjistruar apo për të zbatuar hipotekën, pengun a ndonjë formë tjetër të garancisë të ndonjë pasurie të ndërmarrjes;

(iii) cilindo akt për të likuiduar, për të konfiskuar ose për të shitur ndonjë pasuri nën hipotekë, peng apo të garantuar në ndonjë mënyrë tjetër ose për të ushtruar kontroll mbi pasurinë e ndërmarrjes dhe

(iv) procedurat rregullative apo veprimet lidhur me parandalimin e ndonjë shkeljeje të dispozitave rregullative, të rregullave apo vendimeve apo kompensimin për shkeljen e tyre, në rastet kur kemi të bëjmë me pretendime monetare ndaj ndërmarrjes.

(b) Pezullimi i veprimeve, i procedurave apo i akteve të çfarëdo lloji nuk zbatohet për:

(i) padinë e ngritur nga ndërmarrja apo nga Agjencia në emër të ndërmarrjes drejtuar palës së tretë;

(ii) padinë e drejtuar ndaj zyrtarëve apo menaxherëve, ku në procedurë nuk përfshihet pasuria e ndërmarrjes;

(iii) procedurën penale ndaj ndërmarrjes, ndaj zyrtarëve dhe menaxherëve të saj;

(iv) transferin ose shitjen e pasurisë së ndërmarrjes gjatë veprimtarisë së rëndomtë të ndërmarrjes, duke përfshirë edhe transaksionet e parapara në këtë Rregullore, veçanërisht në nenin 5 të saj;

(v) procedurat apo veprimet rregullative lidhur me parandalimin e ndonjë shkeljeje të dispozitave rregullative, të rregullave apo vendimeve apo kompensimin për shkeljen e tyre në rastet kur kemi të bëjmë me pretendime monetare ndaj ndërmarrjes dhe

(vi) inspektimet dhe kërkesat për inspektim të bëra nga zotëruesit e hipotekave të regjistruara, të pengjeve të përfunduara apo personave të ngarkuar ngjashëm lidhur me pasurinë e ndërmarrjes.

5.2 Brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data e vendimit për moratorium, Agjencia nxjerr njoftim në pajtim me dispozitat e lajmërimeve gjatë dy ditëve të njëpasnjëshme të punës dhe gjatë fundjavës vijuese.

(a) Njoftimi përfshin këto informacione:

(i) datën dhe përshkrimin e vendimit të moratoriumit;

(ii) referencën në këtë Rregullore dhe të drejtat e kreditorëve sipas saj;

(iii) caktimin e një administratori gjatë afatit kohor të përcaktuar në nenin 8.1;

(iv) detajet për procesin e dorëzimit të ankesave dhe

(v) njoftimin mbi mundësinë e votimit për planin e riorganizimit të ndërmarrjes.

(b) Agjencia mund të përfshijë edhe informacione të tjera në kuadër të njoftimit të shpallur nëse i konsideron të duhura.

5.3 Nga data e vendimit për moratorium deri në datën e caktimit të një administratori, ndërmarrja vazhdon të menaxhohet sipas autorizimit administrativ të Agjencisë, gjë që ndërmarrjen e obligon menjëherë që të përgatisë inventarin e tërë pronës, pasurisë dhe borxheve të njohura të saj.

(a) Ndërmarrja përshpejton regjistrimin e tërësishëm të pronës së tundshme e të patundshme, inventarit, borxheve të njohura deri në ditën e emërimit të drejtorit, i cili regjistrim përfshin këto, por jo vetëm këto, si në vijim

(i) pasurinë e luajtshme, të paluajtshme, atë materiale apo jomateriale, kudoqoftë ajo, qoftë në ruajtje apo posedim të ndërmarrjes a të palëve të treta pavarësisht nga ekzistimi i ndonjë personi të ngarkuar mbi të;

(ii) kërkesat dhe ndjekjet gjyqësore të ndërmarrjes ndaj cilitdo personi;

(iii) pasurinë e fituar nga ndërmarrja pas datës së vendimit të moratoriumit;

(iv) qiranë, të hyrat dhe fitimet e krijuara nga shfrytëzimi i pasurisë së ndërmarrjes apo drejtimit të biznesit të asaj ndërmarrjeje dhe

(v) të drejtat kontraktuese, licencat a të drejtat tjera të krijuara apo të dhëna me ligjin në fuqi.

(b) Regjistrimi i tërësishëm i pronës së luajtshme e të palueuajtshme dhe i borxheve nuk përfshin “pasurinë pensionale” apo “të drejtat e dhëna” ashtu siç janë përkufizuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 “Mbi pensionet në Kosovë”.

5.4 Nga dita e vendimit për moratorium deri në datën e emërimit dhe bazuar në dispozitat e nënënit 5.5 poshtë, ndërmarrja kërkon leje paraprake me shkrim nga Agjencia mbi vlefshmërinë e cilitdo nga transaksionet vijuese:

(a) shitjen, përvetësimin ose transferimin e pronës së ndërmarrjes, përpos tokës:

(b) arritjen e ndonjë marrëveshje për hua;

(c) anulimin apo përfundimin e kontratave apo marrëveshjeve;

(d) fillimin apo përfundimin e procedurës ligjore ose të arbitrazhit;

- (e) heqjen dorë nga të drejtat apo nga titullari;
- (f) veprime të tjera të përcaktuara nga Agjencia dhe
- (g) pagimin e rrogave punëtorëve, me kusht që Agjencia të miratojë pagesat e tilla vetëm deri në atë masë që fondet e shfrytëzuara për pagesat e tilla të sigurohen nga të ardhurat e ndërmarrjes ose ndërmarrjes t'i sigurohen pjesërisht apo tërësisht nga IPVQ-të, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës a nga ndonjë donator.

5.5 Nga data e vendimit për moratorium deri në datën e emërimit, ndërmarrja, me pëlqimin e shkruar të Agjencisë apo vetë Agjencia duhet të marrin leje nga gjykata për vlefshmërinë e cilitdo nga transaksionet vijuese:

- (a) shitjen, dhënien, tjetërsimin, transferin ose qiradhënien e çfarëdo pasurie tokësore, në tërësi apo pjesërisht dhe
- (b) krjimin e pengjeve, të hipotekave apo të sigurive të tjera ndaj pasurisë së ndërmarrjes apo të ndonjë pjese të saj.

Neni 6

Detyrimet e shërbimit të ofruesve të shërbimeve komunale

Ofruesi i shërbimeve komunale, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në furnizuesin e energjisë elektrike, të gazit, të nxemjes qendrore, të ujit, të hedhurinave, të shërbimeve postare dhe të telekomunikacionit nuk mund të ndryshojë, të refuzojë apo të ndërpresë shërbimet e tilla për ndërmarrjen për shkak të dorëzimit të kërkesës për riorganizim të ndërmarrjes, nxjerrjes së vendimit të moratoriumit, konfirmimit të planit të riorganizimit apo nëse ndërmarrja nuk ka paguar për këto shërbime me kusht që ndërmarrja të paguajë për shërbimet e tilla të cilat i janë ofruar pas datës së vendimit të moratoriumit. Ofruesit e shërbimeve komunale mund të insistojnë në parapagim të arsyeshëm për mallra dhe shërbime që duhet ofruar pas kësaj date dhe administratori i parasheh dispozitat përkatëse për parapagimet e tilla në planin e riorganizimit.

PJESA III **ADMINISTRATORI**

Neni 7

Tenderimi për administrator dhe ofrues të shërbimeve

7.1 Sa më shpejt që praktikisht të jetë e mundur, Agjencia shpall tender duke kërkuar oferta nga ofertuesit e përshtatshëm për të kryer punën e administratorit ose ofruesit të shërbimeve të tjera profesionale (ofrues i shërbimeve) në procedurën e riorganizimit sipas kësaj Rregulloreje.

- (a) Agjencia e shpall njoftimin për tender në pajtim me procedurat e shpalljeve.

(b) Shpallja e njoftimit për tender përfshin kriteret minimale të kualifikimit, kriteret e vlerësimit lidhur me kualifikimet e ofertuesit dhe kërkesën që ofertuesit të sigurojnë dëshmi për përvojën e mëparshme, kur ata kanë vepruar, në përmasa ndërkombëtare, në rastet e paaftësisë për pagim të subjekteve me borxhe dhe me pasuri të një vlere dhe lloji të ngjashëm me ato të ndërmarrjes në fjalë.

7.2 Ofertat e tenderit të pranuar nga Agjencia vlerësohen në bazë të kriterëve të shpallura ku merren parasysh pagesat e propozuara, të cilat do t'i ngarkojnë ofertuesit, duke pasur parasysh se pagesat e tilla do të jenë të mjaftueshme për të tërhequr ofertuesit kompetent dhe të kualifikuar.

(a) Agjencia cakton një komision për të vlerësuar të gjitha ofertat e dorëzuara dhe për të përgatitur një raport vlerësimi për gjykatën, duke përfshirë edhe propozimin për ofertuesit më të përshtatshëm për t'u caktuar nga gjykata si administrator dhe ofrues të shërbimeve. Ky komision do të përfshijë pesë anëtarë të caktuar nga Bordi i Agjencisë.

(b) Brenda pesë (5) ditëve të punës nga përgatitja e raportit të vlerësimit, Agjencia ia dorëzon raportin gjykatës së bashku me propozimet për administratorët dhe ofruesit e shërbimeve më të përshtatshëm.

Neni 8

Emërimi dhe shkarkimi i administratorit

8.1 Jo më vonë se tre (3) muaj nga data e vendimit të moratoriumit, gjykata emëron administratorin për ndërmarrjen duke marrë parasysh propozimet dhe raportin e vlerësimit të dorëzuar nga Agjencia (data e emërimit). Me kërkesë të Agjencisë, gjykata mund të vazhdojë afatin e emërimit të administratorit për aq kohë sa e konsideron të nevojshme, me kusht që koha e tërësishme nga data e vendimit për moratorium deri në datën e emërimit të mos kalojë katër (4) muaj.

8.2 Gjykata emëron jo më shumë se tre administratorë për të punuar së bashku apo veçantë si administratorë të ndërmarrjes në fjalë. Gjykata emëron një apo më shumë nga ofruesit e shërbimeve sipas nevojës.

8.3 Në çdo kohë kreditori i kualifikuar ose komisioni i kreditorëve mund të paraqesin kërkesë në gjykatë duke e kundërshtuar emërimin e propozuar apo duke kërkuar shkarkimin e administratorit.

(a) Çdo kundërshtim i emërimit të propozuar apo kërkesë për shkarkimin e administratorit mund të bëhet duke u bazuar vetëm në faktin se i emëruari apo administratori:

(i) nuk është i kualifikuar të jetë administrator i ndërmarrjes;

(ii) ka gjasa të jetë tepër i anshëm ndaj ndërmarrjes ose ndaj njërit apo më shumë kreditorëve;

(iii) në çdo kohë para apo pas emërimit është angazhuar në akte të paligjshme lidhur me sjelljen e tij profesionale si administrator i një ndërmarrjeje apo si administrator ose

(iv) i nënshtrohet një konflikti të interesit.

(b) Çdo kërkesë me të cilën kundërshtohet emërimi i propozuar apo kërkohet shkarkimi i administratorit duhet të shoqërohet me dëshmi për:

(i) bazën e kundërshtimit të tillë ashtu siç është paraparë në (a) lart;

(ii) caktimin e një të emëruari apo administratori alternativ dhe

(iii) miratimin me shkrim nga Agjencia me të cilin tregohet pranimi i emërimit të tillë.

8.4 Nëse gjykata urdhëron shkarkimin e drejtorit, drejtori ekzistues doemos duhet të jetë kooperativ me drejtorin alternativ ose me Agjencinë në mënyrë që drejtori i tillë ose Agjencia të mund të kërkojnë në formë të arsyeshme e të kuptueshme dorëzimin e librave, duke përfshirë dokumentacionin e duhur dhe llogaritë bankare të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërmarrjes.

Neni 9

Pagesa dhe shpenzimet e administratorit

9.1 Shuma për pagesën dhe shpenzimet e administratorit do të përcaktohet nga Agjencia në pajtim me ofertat e dorëzuara për tenderin, që përfshijnë pagesën dhe shpenzimet e të gjithë ofruesve të angazhuar të shërbimeve të ofruara për ndërmarrjen.

9.2 Pagesa dhe shpenzimet për administratorin do të paguhet nga resurset e parave të gatshme të ndërmarrjes apo nga fitimi i shitjes së pasurisë së ndërmarrjes, në pajtim me prioritetin e caktuar në nenin 36.

9.3 Administratori i Agjencisë mund të pajtohet me Qeverinë e Kosovës (Qeveria), me kreditorin ose me cilëndo palë të tretë që pajtohet t'i bëjë pagesat administratorit dhe t'i paguajë shpenzimet e plota apo të pjeshme dhe se Qeveria, kreditori ose pala e tretë kanë të drejtë t'i kompensojnë shumën e këtyre pagesave dhe shpenzimeve në tërësi apo pjesërisht në pajtim me nenin 9.2 dhe 36 në vend të administratorit.

9.4 Në rast se administratori ose donatori, Qeveria ose kreditorët që pajtohen të financojnë pagesat dhe shpenzimet e administratorit nuk janë të kënaqur me shumën që Agjencia e ka përcaktuar si pagesa dhe shpenzime të administratorit, gjykata pas kërkesës së administratorit ose donatorit, Qeverisë apo kreditorëve që janë pajtuar që të financojnë pagesat dhe shpenzimet e administratorit vendos për këto pagesa dhe shpenzime si ta sheh të arsyeshme.

Neni 10
Detyrimi, përgjegjësia dhe raportimi i administratorit

10.1 Administratori është i pavarur nga Agjencia, nga ndërmarrja, nga kreditorët dhe nga IPVQ-të, por ai duhet të jetë i vetëdijshëm për kompetencat dhe përgjegjësitë që ka dhe prandaj duhet të tregohet i kujdesshëm dhe i arsyeshëm në punën e tij.

10.2 Administratori është i obliguar të depozitojë një shumë në gjykatë ose t'i japë gjykatës një obligacion që do të shërbejë si garanci për kryerjen si duhet të të gjitha detyrave sipas kësaj Rregulloreje.

10.3 As administratori, as Agjencia dhe as të punësuarit e tyre përkatës, personeli apo këshilltarët nuk janë përgjegjës për:

(i) humbjet e shkaktuara nga kreditori, nga ndërmarrja, nga cilido punonjës ose nga ndonjë palë tjetër për pasojat dhe dëmet që janë rezultat i vendimeve apo i veprimeve të ndërmarrura a të pandërmarrura nga fusha e tij e përgjegjësisë, me kusht që në rastin e administratorit ai të ketë zbatuar standardin e përkujdesit të përcaktuar në nënnenin 1 më lart.

(ii) obligimet e ndërmarrjes lidhur me parandalimin apo rregullimin e cenimeve ndaj shëndetit, ndaj sigurisë apo ndaj ambientit.

10.4 Pa paragjykuar detyrimet e ndërmarrjes dhe të menaxhmentit, ku administratori merr apo jep ndonjë pronë që nuk është pronë e ndërmarrjes, dhe për të cilën në kohën e marrjes apo shitjes ai beson, dhe ka bazë të arsyeshme që të besojë, se ka të drejtë të marrë apo të shesë atë pronë, administratori nuk është përgjegjës në lidhje me çfarëdo humbje ose dëmtimi të shkaktuar nga marrja ose dhënia e një pronë të tillë, përveç nëse humbja apo dëmtimi është shkaktuar nga pakujdesia e madhe e administratorit.

10.5 Administratori mban shënime për kryerjen e funksioneve të tij dhe për atë qëllim do të regjistrojë secilin veprim të tij që ka të bëjë me ushtrimin e përgjegjësisë dhe kompetencave sipas nenit 11 dhe me administrimin e ndërmarrjes, në pajtim me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

(a) nëse funksionet e administratorit kryhen nga dy apo me shumë persona, çdo kontest dhe çdo zgjidhje e kontestit mes tyre do të evidencohet në shënime.

(b) Administratori dorëzon raporte tremujore për përparimin e arritur duke përfshirë edhe kopjet për Agjencinë, për Komisionin e kreditorëve dhe për gjykatën, dhe kopjet ia siguron çdo kreditori pas dorëzimit të kërkesës me shkrim.

(c) Pa cenuar dispozitat paraprahe, administratori ofron kohë pas kohe informata dhe të dhëna të azhurnuara shtesë në lidhje me veprimtarinë e tij, sipas kërkesës së arsyeshme të Agjencisë ose të Komisionit të kreditorëve.

Neni 11
Përgjegjësitë dhe kompetencat e administratorit

11.1 Administratori është i autorizuar të drejtojë menaxhmentin që të ndërmarrë veprime në pajtim me çfarëdo udhëzimi të dhënë ligjshëm nga administratori ose nga Agjencia. Administratori ka përgjegjësi dhe kompetenca që të marrë çfarëdo veprimi të nevojshëm apo të duhur për të menaxhuar punët, biznesin dhe pronën e ndërmarrjes me qëllim të riorganizimit të ndërmarrjes në një veprimtari praktike të biznesit, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në:

- (a) përfaqësimin dhe kryerjen e punëve të ndërmarrjes;
- (b) krijimin dhe plotësimin e regjistrit të të gjitha pasurive dhe detyrimeve të ndërmarrjes dhe degëve të saj ndihmëse siç është përpiluar nga ndërmarrja nën mbikëqyrjen e Agjencisë,
- (c) përgatitjen dhe mirëmbajtjen e regjistrave dhe korrespondencës afariste të ndërmarrjes;
- (d) marrjen në posedim, mbledhjen, rifitim dhe ndërmarrjen e të gjitha hapave të nevojshëm për realizimin e pronës së ndërmarrjes dhe, për këtë qëllim, pjesëmarrjen në procedurë apo fillimin e procedurave që administratori i sheh të dobishme.
- (e) shitjen, dhënien me qira apo heqjen dorë në mënyrë tjetër nga ndonjë pasuri e ndërmarrjes përmes ankandit ose kontratës private, me kusht që kushtet e shitjes apo zgjedhja e ofertuesve për çfarëdo pasurie materiale të ndërmarrjes të jetë publikuar në përputhje me nenin 49; kushtet e çfarëdo shitjeje apo zgjedhjeje të ofertuesve në çfarëdo shitje përmes tenderit, përfshirë ndonjë investim, punësim, angazhim mjedisor ose angazhime të tjera që kërkohen ose që bëhen nga ofertuesit a blerësit duhet të pasqyrojnë kushtet e planit të vërtetuar për riorganizim;
- (f) lejimin ose pranimin e heqjes dorë nga ndonjë kontratë për dhënie apo marrje me qira të çfarëdo prone të ndërmarrjes dhe pranimin për dhënie apo marrje me qira të çfarëdo prone që kërkohet apo që është e përshtatshme për të kryer afarizmin e ndërmarrjes;
- (g) mbledhjen apo huazimin e parave dhe dhënien e letrave me vlerë mbi pasurinë e ndërmarrjes sipas dispozitës së nenit 13;
- (h) ekzekutimin në emër të interesit dhe në interes të ndërmarrjes të çfarëdo veprimi, fature ose dokumenti tjetër;
- (i) tërheqjen, pranimin, plotësimin ose miratimin e çdo kambiali ose deftese të borxhit në emër dhe në interes të ndërmarrjes;
- (j) përdorimin, hapjen, mbylljen dhe konsolidimin e llogarive bankare të ndërmarrjes dhe pagimin apo mundësimin e pagimit të çfarëdo pagese të rastësishme ose të nevojshme për kryerjen e funksioneve të administratorit;

(k) emërimin e avokatëve, kontabilistëve, vlerësuesve ose personave të tjerë profesionalisht të kualifikuar që janë të nevojshëm për të ndihmuar administratorin në kryerjen e funksioneve të tij;

(l) arritjen, mbrojtjen dhe lidhjen e ndonjë marrëveshje ose arritjen e një kompromisi për të shmangur apo për t'i dhënë fund çfarëdo veprimi ose procedure ligjore në emër të dhe në interes të ndërmarrjes kur kjo është e nevojshme për funksionimin dhe riorganizimin e ndërmarrjes;

(m) emërimin e ndonjë agjenti për të kryer afarizmin e nevojshëm të ndërmarrjes, të cilin administratori nuk është në gjendje ta kryej vet ose i cili mund të bëhet më mirë nga një agjent, përfshirë Agjencinë;

(n) punësimin ose përjashtimin e punëtorëve;

(o) sigurimin, përfundimin ose ruajtjen e kontratave të sigurimit lidhur me biznesin dhe pronën e ndërmarrjes;

(p) renditjen dhe deklarimin e bankrotimit ose të likuidimit të çdo personi që i ka borxh ndërmarrjes, pranimit të dividendave dhe miratimi i autorizimeve për pasurinë e besuar për ndërmarrjen si kreditor i cilitdo nga personat e tillë;

(q) paraqitjen ose mbrojtjen e një kërkesë për likuidimin e ndërmarrjes në pajtim me këtë Rregullore;

(r) dryshimin e gjendjes së zyrës së regjistruar të ndërmarrjes;

(s) ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera që mund të jenë karakteristike në ushtrimin e aktiviteteve të mëparshme.

11.2 Administratori mund të heqë dorë nga këto prona apo pasuri të ndërmarrjes, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në dorëzimin e pronës apo të pasurisë së tillë, të cilat i nënshtrohen intereseve valide të sigurisë, me kusht që administratori të ketë kërkuar nga gjykata lejimin e heqjes dorë dhe gjykata t'a ketë lejuar këtë:

(a) çdo pronë apo pasuri e rëndë apo jofitimprurëse, që sipas mendimit të arsyeshëm të administratorit nuk ka mundësi të ketë realizim fitimprurës;

(b) çdo pronë apo pasuri, mbi të cilën sipas mendimit të arsyeshëm të administratorit ndërmarrja nuk mund të ushtrojë kontroll efikas apo mbi të cilën vetë administratori a vetë ndërmarrja nuk mund të ushtrojnë kontroll efikas.

11.3 Administratori mund të kërkojë nga gjykata që t'i lejohet heqja dorë pavarësisht se ai, Agjencia apo menaxhmenti kanë marrë në pronësi, janë orvatur ta shesin apo t'i ushtrojnë ndryshe të drejtat e pronësisë apo menaxhimit në raport me pronën apo pasurinë nga e cila mëtojnë të heqin dorë.

11.4 Për kërkesën e tillë të heqjes dorë gjykata merr vendim brenda pesë (5) ditëve të punës nga dorëzimi i kërkesës së administratorit.

Neni 12

Efektet e emërimit dhe veprimet e menjëhershme nga administratori

12.1 Ndërmjet datës së emërimit dhe datës së vërtetimit të planit për riorganizim për veprimet e mëposhtme kërkohet pëlqimi i gjykatës, me kusht që menaxhmenti dhe zyrtarët e ndërmarrjes kërkojnë pëlqimin me shkrim nga administratori që të veprojnë për apo në emër të ndërmarrjes:

(a) shitjen, dhënien, tjetërsimin, bartjen apo dhënien me qira të pronës së ndërmarrjes, si tërësi apo pjesërisht, përfshirë çfarëdo bartje për përmbushjen e detyrimeve ekzistuese mbi vlerën prej pesë mijë (5,000) Euro, apo në rast të dhënies me qira të pronës, pagesat e qirasë mbi vlerën prej dy mijë (2,000) Euro në muaj në rastet kur kontrata është për më pak se 6 muaj;

(b) anulimin ose përfundimin e çfarëdo kontrate apo marrëveshje tjetër nga përfundimi i kontratave të marrëdhënies së punës, mbi vlerën prej pesë mijë (5,000) Euro;

(c) nisjen apo përfundimin e procedurave të ligjshme të arbitrazhit;

(d) çfarëdo heqje dorë nga të drejtat apo titullarët mbi vlerën prej pesë mijë (5,000) Euro;

(e) krijimin e pengjeve apo hipotekave ose një siguri tjetër ndaj pronës së ndërmarrjes dhe

(f) çfarëdo veprimi tjetër i përcaktuar nga administratori.

12.2 Menjëherë pas datës së emërimit dhe në përgatitje të publikimit të njoftimit të emërimit dhe mbajtjes së mbledhjes nismëtare të kreditorëve administratori i ndërmerr këto veprime:

(a) rishqyrtimin e përciptë të dokumentacionit në dispozicion dhe kalkulimin e vlerës së përgjithshme të të gjitha detyrimeve që duhet të paguhen nga ndërmarrja, duke u bazuar në vlerësimin më të mirë pas këtij rishqyrtimi;

(b) konsultimin me përfaqësuesit e këtyre punëtorëve të ndërmarrjes të cilët pretendojnë të jenë kreditorë të ndërmarrjes dhe përfaqësuesve të çfarëdo sindikate të njohur për administratorin dhe që janë në dispozicion, në mënyrë që të pajtohen jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) individë që mund të marrin pjesë në mbledhjen nismëtare të kreditorëve që të përfaqësojnë këta punëtorë dhe të votojnë në emër të punëtorëve; me kusht që në rast se administratori, punëtorët e tillë dhe përfaqësuesit e sindikatës nuk arrijnë marrëveshje brenda dhjetë (10) ditë pune, administratorit do t'i jepet e drejta të emërojë përfaqësues të tillë që merr pjesë dhe voton në mbledhjen nismëtare të kreditorëve në emër të punëtorëve, të cilët pretendojnë të jenë kreditorë dhe

(c) fillimin e hartimit të planit për riorganizim që do të përfundohet brenda katër (4) muajsh prej datës së emërimit.

12.3 Pas datës së emërimit, sa më shpejtë që praktikisht të jetë e mundur, administratori i merr të gjitha veprimet e përshtatshme në rrethanat ekzistuese për të lokalizuar, për të ushtruar sekuestrimin, për të mbyllur, për të mbrojtur me kujdes dhe për të zbatuar masat e arsyeshme të nevojshme për mirëmbajtjen e pronës së ndërmarrjes:

(a) Administratori është i autorizuar të shesë mallra që prishen shpejt dhe pasuri që kërkon shpenzime të mëdha për mirëmbajtje, ashtu siç e sheh të arsyeshme;

(b) Në varësi të heqjes dorë sipas nenit 11.2, administratori i lëshon njoftimin mbi sekuestrim cilësdo palë të tretë e cila ka në kujdestari apo në posedim pronën apo pasurinë e ndërmarrjes dhe sipas nevojës bën kërkesë për dorëzim të kujdestarisë apo posedimit të një prone a pasurie të këtillë.

(c) Administratori do t'i drejtohet çdo gjykate që është kompetente për pranimin e njoftimit për sekuestrim të çfarëdo prone apo pasurie të ndërmarrjes që zakonisht duhet të ndodhet në Kosovë, por që momentalisht janë jashtë Kosovës, nëse nuk janë të sigurta, jopraktike apo të papërshtatshme për të bërë një gjë të tillë. Në rrethana të tilla administratori mund ta refuzojë një pronë të tillë sipas nenit 11.2 të kësaj Rregulloreje.

12.4 Sapo të jetë e realizueshme pas datës së emërimit, administratori vepron së bashku me menaxhmentin për ta përfunduar inventarizimin e tërë pronës, pasurisë dhe detyrimeve të njohura të ndërmarrjes ashtu siç është përkufizuar në nenin 5.3.

(a) Inventarizimi i tërë pronës, pasurisë dhe detyrimeve të njohura kryhet brenda tre (3) muajve prej datës së emërimit.

(b) Gjykata, me kërkesë të administratorit, mund ta vazhdojë këtë afat të fundit me kusht që koha e plotë për përfundimin e këtij inventarizimi të mos i kalojë gjashtë (6) muaj prej datës së emërimit.

(c) Pas përfundimit, administratori e përditëson inventarin me informata lidhur me tërë pasurinë e mbledhur nga administratori në emër të ndërmarrjes ose të cilat i ka siguruar ndërmarrja gjatë kryerjes së zakonshme të punës së saj.

Neni 13

Marrja e kredisë së garantuar dhe të pagarrantuar

13.1 Nga data e Vendimit për moratorium deri në datën e emërimit, administratori ose ndërmarrja, me miratim paraprak në formë të shkruar nga agjencia apo vetë agjencia, mund të marrin kredi të pagarrantuar gjatë kryerjes së zakonshme të veprimeve afariste të ndërmarrjes. Kredia e tillë është shpenzim administrativ dhe paguhet në pajtim me prioritetet e paraqitura në nenin 36.

13.2 Administratori mund të marrë në ngarkim ose të japë garanci mbi pronën ose pasurinë e ndërmarrjes pa miratimin paraprak të gjykatës, nëse kjo kërkohet me qëllim të mbledhjes së të ardhurave për drejtimin e afarizmit të ndërmarrjes sipas rrjedhës së zakonshme. Administratori mund të japë garanci për pasurinë e ngarkuar që konsiderohet e një rangu më të lartë se ajo pasuri e ngarkuar dhe ato letra me vlerë që kanë ekzistuar para vendimit të moratorium, me kusht që:

- (a) gjykata ta ketë dhënë pëlqimin e saj;
- (b) me arsye të pritet që prona apo pasuria në ngarkim të tillë ka vlerë të mjaftueshme për ta siguruar kërkesën ekzistuese të sigurisë përkundër radhitjes në rang më të ulët nga kërkesa që është paraqitur pas datës së vendimit për moratorium dhe
- (c) ndërmarrja të mos mund të sigurojë të ardhura në ndonjë mënyrë tjetër.

Neni 14

Vazhdimi dhe refuzimi i kontratave

14.1 Administratori mund të vendosë që ta refuzojë ose ta vazhdojë një kontratë që nuk është përmbushur materialisht nga kreditori, me kusht që çdo refuzim nga ana e administratorit për ta përmbushur kontratën t'i hapë rrugën kërkesës së kreditorit për dëmshpërblim.

14.2 Nëse administratori e refuzon një kontratë e cila ka më shumë se tri (3) vjet deri në kohën e skadimit të saj ose deri në datën tjetër të përfundimit, dëmet që duhet paguar kufizohen në dhjetë për qind (10%) të vlerës së kontratës.

(a) Vlera e kontratës së tillë është shuma e parave që me arsye parashikohet t'i mbetet borxh kreditorit deri në:

- (i) datën e skadimit ose
- (ii) datën e ardhshme të përfundimit të kontratës

varësisht se cila ndodh më herët.

(b) Nëse kontrata e tillë është për furnizim me mallra ose shërbime nga ndërmarrja dhe mallrat ose shërbimet e tilla janë paguar, vlera e kontratës është vlera e drejtë e tregut për mallrat dhe shërbimet e tilla për të cilat ndërmarrja është pajtuar t'i sigurojë deri në:

- (i) datën e skadimit ose
- (ii) datën e ardhshme të përfundimit,

varësisht se cila ndodh më herët;

Me kusht që data e ndërprerjes të jetë data e parë kur kreditori ose ndërmarrja mund ta ndërprejë kontratën dhe, për më tepër, me kusht që vlera e drejtë e tregut të përcaktohet nga administratori dhe të mund të kundërshtohet nga kreditori në gjyq.

14.3 Nëse ndërmarrja nuk i plotëson zotimet e veta ose e ka shkelur kontratën, administratori mund të vendosë ta vazhdojë kontratën, me kusht që mosplotësimi i zotimeve ose shkelja të rregullohen thelbësisht dhe kreditori të vëhet në pozitë të njëjtë me atë para shkeljes. Administratori i ofron garancitë e duhura lidhur me aftësinë e ndërmarrjes për përmbushje e detyrimeve sipas kontratës së vazhduar.

14.4 Në rastin kur administratori ka vendosur ta vazhdojë një kontratë dhe kontrata e tillë më pas shkelet thelbësisht nga ndërmarrja, dëmshpërblimi për shkeljen e tillë trajtohet si kërkesë sipas planit të vërtetuar për riorganizim.

14.5 Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e kontratës e cila e ndalon transferimin, administratori mund të vendosë ta lejojë kontratën, duke përfshirë kontratën të cilën administratori ka vendosur ta vazhdojë. Nëse kreditori e kundërshton transferimin, gjyqi e miraton transferimin e tillë, me kusht që:

- (a) përfituesi të ketë mundësi që t'i kryejë obligimet e kontratës;
- (b) kreditori të mos pësojë dëme të paarsyeshme si rezultat i transferimit dhe
- (c) tranferimi të jetë i domosdoshëm për zbatimin efikas të planit të vërtetuar për riorganizim.

14.6 Administratori vendos ta vazhdojë ose ta refuzojë kontratën jo më vonë se njëzet (20) ditë pas datës së nxjerrjes së planit të vërtetuar për riorganizim nga ana e gjykatës.

Neni 15 Anulimi i shitblerjeve

15.1 Administratori mund të kërkojë nga gjykata urdhër për anulimin e çdo shitblerjeje të pronës apo pasurisë së ndërmarrjes e cila është bërë gjatë periudhës prej 22 mars 1989 deri në datën e vendimit të moratoriumit, nëse vlejné ndonjëra prej kritereve në vijim dhe shitblerja e tillë:

- (a) është bërë për më pak se vlera e drejtë;
- (b) ka zvogëluar pasurinë e përgjithshme të ndërmarrjes;
- (c) ka pasur për qëllim t'i dëmtojë interesat e kreditorëve;
- (d) ka pasur për qëllim shkatërrimin, shtyrjen ose pengimin e aftësisë së kreditorëve për të mbledhur ankesa duke ia transferuar pasurinë palës së tretë në rastet kur pala e tretë ka qenë në dijeni ose është dashur të jetë në dijeni për qëllimin e tillë;
- (e) ka qenë rezultat i shitblerjes me kreditorin përmes së cilës kreditori ka marrë më shumë se një pjesë proporcionale të pasurisë së ndërmarrjes dhe shitblerja është bërë në kohën kur kreditori është dashur ta dijë se ndërmarrja nuk ka qenë në gjendje t'i plotësojë obligimet e saj ose

(f) shitblerja, pagesa a furnizimi në lidhje me shitblerjen ka shkelur një ose më shumë rezoluta të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose të Rregullores së Këshillit të Bashkimit Evropian (EC) që shqiptojnë sanksione ndërkombëtare, pavarësisht që transferi i tillë mund të jetë pranuar me vendim të gjyqit ose me vendim të arbitrazhit.

15.2 Çdo transfer sipas këtij neni përfshin çdo mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të bartjes, të shitjes, të këmbimit, të dhurimit, të pagimit, të dhënies, të dhënies së pengut, të hipotekës ose të drejtave të tjera.

15.3 Gjatë shqyrtimit të urdhrimit sipas këtij neni, gjykata mban ekuilibrin ndërmjet interesave të ndërmarrjes dhe nevojës për t'i trajtuar kreditorët në mënyrë të drejtë lidhur me:

(a) të drejtat e përfituesit në mirëbesim të pasurisë së ndërmarrjes dhe të drejtat ndaj saj;

(b) nevojën për ruajtjen e një sigurie të arsyeshme në shitblerjet komerciale dhe

(c) nevojën për t'u marrë me kërkesën e administratorit në mënyrë të shpejtë.

Neni 16

Obligimi për të bashkëpunuar me administratorin

Ndërmarrja, menaxhmenti, punëtorët e ndërmarrjes, duke përfshirë punëtorët e mëparshëm, dhe të gjithë personat përkatës, duke përfshirë ndonjë autoritet publik, IPVQ-të dhe agjencia bashkëpunojnë me administratorin dhe sigurojnë qasje në të gjitha dokumentet dhe informatat lidhur me aktivitetet dhe veprimet e ndërmarrjes, duke përfshirë pa u kufizuar të gjitha informatat lidhur me kërkesat, pagesat, transferet ose tjetërsimet e ndërmarrjes dhe të gjitha pagesat, transferet ose marrëveshjet afariste me ndërmarrjen.

PJESA IV

KREDITORËT, TAKIMET E KREDITORËVE DHE PLANI PËR RIORGANIZIM

Neni 17

Njoftimi i kreditorëve dhe dëshmia e kërkesës

17.1 Në ditën e emërimit gjykata ia dorëzon njoftimin për emërimin e tillë Agjencisë e cila nxjerr njoftim publik për këtë emërim (njoftimin për emërim) në pajtim me dispozitat për shpallje sipas nenit 49 të kësaj Rregulloreje brenda tri (3) javësh prej datës së emërimit. Në njoftimin për emërim përfshihen:

(a) emri dhe të dhënat kontaktuese për administratorin (administratorët) e emëruar nga gjykata duke iu referuar kësaj Rregulloreje;

(b) oraret e përafërta që kanë të bëjnë me detyrat e administratorit sipas kësaj Rregulloreje;

(c) informatën që administratori do ta hartojë dhe shpërndajë planin e propozuar për riorganizim të ndërmarrjes në fjalë;

(d) njoftimin që kreditorët, borxhi individual ose kolektiv i të cilëve arrin një shumë të llogaritur në euro, e cila është e barabartë me 5% të vlerës së përgjithshme të të gjitha detyrimeve të papaguara të ndërmarrjes (kreditorët kualifikues), duke qenë se shumta e tillë është vlerësimi më i mirë i administratorit duke u bazuar në informatat e disponueshme në atë kohë lejohet të dorëzojë një propozim alternativ për riorganizimin e ndërmarrjes (planin alternativ për riorganizim) dhe

(e) ndonjë informatë tjetër relevante të cilën administratori e konsideron si të përshtatshme.

17.2 Njoftimi për emërim përfshin edhe njoftimin e administratorit për kreditorët e mundshëm të ndërmarrjes, me të cilin kërkon paraqitjen formale në çfarëdo forme të arsyeshme (përfshirë formën elektorinike) të cilën administratori e konsideron të përshtatshme për të gjitha kërkesat dhe informatat e kreditorit ashtu siç kërkohet nga administratori (dëshmia e kërkesës) duke përfshirë edhe të mëposhtmet:

(a) emrin dhe adresën, pëfshirë të dhënat e tjera për kontak të kreditorit ose të pretenduesit;

(b) shumën e plotë monetare të kërkesës me interes të identifikuar ndarazi dhe natyrën e kërkesës që e identifikon nëse kërkesa është e drejtuar kundër një pasurie të caktuar të ndërmarrjes në fjalë ose nëse kërkon që ndërmarrja ta plotësojë një obligim të caktuar që nuk është pagesë për pretenduesin ose kreditorin;

(c) hollësitë lidhur me kursin e shkëmbimit të parave;

(d) një kopje të ndonjë dokumenti në bazë të të cilit mund të provohet detyrimi ose kërkesa;

(e) të dhënat lidhur me mënyrën dhe kohën e shkaktimit të detyrimit ose të paraqitjes së kërkesës;

(f) të dhënat për ndonjë letër me vlerë që mbahet, vlerën e letrës së tillë me vlerë, datën kur është dhënë dhe hollësitë e ndonjë regjistrimi a të ndonjë veprimi që nevojitet për bërjen e vlefshme e letrës me vlerë ndaj palëve të treta dhe

(g) ndonjë informatë tjetër të përshtatshme lidhur me detyrimin ose kërkesën të cilën kreditori ose kërkuesi mund ta konsiderojnë të përshtatshme ose të cilën administratori e konsideron të përshtatshme për t'u dorëzuar.

17.3 Kërkesat të cilave nuk iu ka kaluar afati konsiderohen me afat të kaluar prej datës së vendimit për moratorium me qëllim të dorëzimit të dëshmisë së kërkesës.

17.4 Kreditori, Qeveria ose ndonjë palë e tretë që është pajtuar të financojë pagesën dhe shpenzimet e administratorit obligohen ta dorëzojnë kërkesën dhe informatat për kreditorin sipas kësaj Rregulloreje, nëse kjo kërkohet nga administratori, me qëllim të kthimit të pagesës ose të shpenzimeve të paguara të administratorit.

17.5 Kur t'i pranojë kërkesat e kërkuara dhe informatat për kreditorin nga kreditorët e mundshëm, administratori, pa vonesa të panevojshme, e njofton ndonjë person që ai ka mendim të arsyeshëm që ai person të jetë pjesëtar i ndërmarrjes ose për kërkesën e të cilit ai ka mendim të arsyeshëm që është qartë e pavërtetë ose e pasaktë.

Neni 18

Mbrojtja e interesave të kreditorëve

18.1 Kurdo pas datës së emërimit dhe me të ofruar dëshmi të përshtatshme dhe të duhura, kreditori i regjistruar i ndërmarrjes mund të kërkojë nga gjykata një urdhër që punët, biznesi dhe pasuria e ndërmarrjes janë duke u menaxhuar ose janë menaxhuar nga administratori në mënyrë të padrejtë e të dëmshme për interesat e kreditorëve në përgjithësi ose për disa prej kreditorëve dhe së paku për kandidatin për kreditor të regjistruar ose që ndonjë veprim a propozim aktual i ndërmarrë apo i pandërmarrë nga administratori është apo do të ishte padrejtësisht e dëmshëm.

18.2 Kur ta marrë kërkesën për një urdhër të tillë sipas këtij neni, gjykata mund ta përpilojë një urdhër të tillë nëse mendon se është e përshtatshme.

Neni 19

Komisioni i kreditorëve

19.1 Komisioni i kreditorëve themelohet nga kreditorët e regjistruar gjatë takimit të parë të kreditorëve dhe përbëhet nga personat e tillë të cilët mund të konsiderohen si përfaqësues të kreditorëve të regjistruar. Komisioni i kreditorëve përfshin së paku tre (3) dhe jo më shumë se shtatë (7) kreditorë të regjistruar.

19.2 Themelimi i komisionit të kreditorëve ose vendimi lidhur me komisionin e tillë të kreditorëve përcillet në gjykatë nëse:

(i) mbizotërojnë rrethanat kur është dukshëm e papërshtatshme ose nuk është e mundur të formohet komisioni i kreditorëve që i përfaqëson të gjithë kreditorët e regjistruar ose

(ii) komisioni ekzistues i kreditorëve pushon së funksionuari në mënyrë të drejtë e efikase.

Gjykata përgatit një urdhër të përshtatshëm që përfshin por që nuk kufizohet vetën në urdhrin që një palë e tretë e përshatshme ose Agjencia të veprojë në emër të të gjithë kreditorëve të regjistruar.

19.3 Komisioni i kreditorëve ka përgjegjësitë dhe kompetencat vijuese:

(a) të pranojë një kopje të raporteve tremujore të administratorit njëkohësisht me gjykatën dhe Agjencinë;

(b) të pranojë njoftime të propozimeve dhe kërkesa të tjera për veprimin e gjykatës të cilat ka gjasa të ndikojnë thelbësisht në të drejtat e kreditorëve të regjistruar;

(c) të kërkojë nga menaxhmenti ose përfaqësuesit e ndërmarrjes të emëruar nga administratori për këtë qëllim të përgjigjen në pyetjet lidhur me ndërmarrjen;

(d) të kërkojë nga administratori që të inicojë padi për anulimin e transaksioneve sipas nenit 15 ose ta refuzojë kërkesën sipas nenit 32 të kësaj Rregulloreje;

(e) të ndajë me kreditorët e regjistruar të cilët nuk janë anëtarë të komisionit të kreditorëve qasjen në informatat të cilat i ka siguruar;

(f) të pranojë kompensim për shpenzimet në pajtim me nenin 36, me kusht që shpenzimet e tilla të jenë të kufizuara në shpenzimin për udhëtim të arsyeshëm dhe në shpenzimin për ekzistencë që ka të bëjë me pjesëmarrjen në takimet e komisionit të kreditorëve;

(g) të veprojë si grup këshillimor për ndërmarrjen, për Agjencinë e administratorin dhe t'i ndihmojë ndërmarrjes, Agjencisë dhe administratorit gjatë proceseve të tyre vendimmarrëse dhe

(h) përgjegjësi e kompetenca të tjera të parapara me këtë Rregullore ose me ndonjë legjislacion shtesë zbatues.

19.4 Administratori mund të refuzojë të ofrojë informata ose t'ia lejojë kreditorit të regjistruar të marrë pjesë në takimet e komisionit të kreditorëve në rrethanat kur administratori ka arsye të besojë që kreditori i tillë i regjistruar ka konflikt me interesat e ndërmarrjes. Në rrethanat kur konflikti i tillë i interesit është i rëndësishëm dhe i vazhdueshëm, administratori mund ta kërkojë largimin e kreditorit të tillë të regjistruar nga komisioni i kreditorëve në pajtim me si vijon:

(a) Me kërkesën e administratorit ose të ndonjë kreditori të regjistruar a të shumicës së anëtarëve të këshillit të kreditorëve, duke e përjashtuar votën e kreditorit të regjistruar largimi i të cilit kërkohet, e i cili i është dërguar gjykatës, por gjykata mund ta largojë anëtarin e këshillit të kreditorëve dhe ta zëvendësojë me një kreditor tjetër të besueshëm të regjistruar.

(b) Arsyet për largimin e një anëtari të komisionit të kreditorëve kufizohet nga sa vijon:

(i) kur ka gjasa që anëtari të jetë padrejtësisht i anshëm ndaj ndërmarrjes ose ndaj një apo më shumë kreditorëve të regjistruar,

(ii) kur anëtari ka konflikt të rëndësishëm të vazhdueshëm të interesit, në pajtim me paragrafin 19.5 më sipër ose kur nuk posedon aftësi për të kontribuar në mënyrë efektive në punën e komisionit të kreditorëve.

Neni 20

Plani për riorganizim

20.1 Plani për riorganizim përmban informata të mjaftueshme për t'ia mundësuar një personi të arsyeshëm afarist të bëjë një zgjidhje të bazuar për votimin apo mosvotimin në favor të një plani të tillë në të cilin përfshihet:

(a) një parathënie e shkurtër e cila e përshkruan në mënyrë të përgjithshme aktivitetin e biznesit të ndërmarrjes dhe rrethanat që kanë çuar në vështirësinë e saj financiare;

(b) përshkrimi i metodës dhe i mjeteve për zbatimin e planit, duke e sqaruar në hollësi të mjaftueshme çfarë masash do të merren për realizimin e riorganizimit, përfshirë ndonjë projektim financiar në të cilin bazohet realizueshmëria e planit për riorganizim;

(c) hollësitë për ndonjë bartje të propozuar të një pjese apo të gjithë biznesit të ndërmarrjes në një korporatë të re apo në ndonjë subjekt tjetër;

(d) hollësitë e ndonjë çështjeje të mundshme të aksioneve ose të strukturës së re të kapitalit apo në një korporatë të re ose në ndërmarrje, në mënyrë që të mundësohet plotësimi i kërkesave a çështja e ndonjë instrumenti të ri të borxhit;

(e) një analizë koncize të shumës së përafërt të parave që mund të jenë në dispozicion për kreditorët nëse ndërmarrja likuidohet para se të riorganizohet në pajtim me planin e propozuar;

(f) një deklaratë të shumës së përafërt të parave dhe të pasurisë të cilat janë të disponueshme për plotësim të plotë ose të pjesërisht të kërkesave të kreditorëve, procedurën për plotësimin e këtyre kërkesave dhe afatin e përafërt për pagesat që duhet të bëhen për ta plotësuar një kërkesë të tillë;

(g) një përshkrim të procedurës që do të shfrytëzohet për shitjen e cilësdo pasurie, duke përshkruar se cilat pasuri do të shiten qoftë me apo pa vazhdimin e ngarkimit mbi atë pasuri, dhe qëllimin e përdorimit të të ardhurave nga shitjet e tilla;

(h) një deklaratë të periudhave të përafërta kohore për përfundimin e planit dhe orarin e përafërt për zbatimin e elementeve kryesore nga kjo;

(i) një përshkrim të menaxhmentit të ndërmarrjes dhe hollësitë e propozimit për kompensimin e tyre në të ardhmen;

(j) një deklaratë të ndonjë qëllimi për mbajtjen apo për shpalljen tepërisht të punëtorëve dhe numrat e kategoritë e përafërta të të punësuarve që do t'i mbajë ndërmarrja;

(k) një përshkrim të ndonjë marrëveshjeje, skeme, përbërjeje ose kompromisi të propozuar me kreditorët lidhur me pagesën e borxheve të tyre;

(l) propozime të hollësishme për dhënien e kontratave të koncesionit, të marrëveshjeve për veprim ose të marrëveshjeve të ngjashme për arritjen e vlerës për ndërmarrjen të shoqëruar nga një sqarim se si kjo do ta përmirësojë gjendjen e kreditorëve;

(m) çfarëdo metode të propozuar për shitje, përfshirë kufirin deri ku do t'i shfrytëzojë administratori metodat dhe resurset e Agjencisë dhe kriteret që do të shfrytëzohen për zgjedhjen e ofertuesve fitues të shitjes ose të kontratave, përfshirë ndonjë kriter pa çmim siç është investimi, punësimi, zotimet për përtëritjen ambientale ose ekonomike dhe zotimet e tjera të ngjashme dhe

(n) datën kur propozohet hyrja në fuqi e planit.

20.2 Të gjitha formulimet e bëra në planin për riorganizim i nënshtrohen ndryshimeve dhe çdo ndryshim i tillë nuk shkakton ndonjë detyrim për administratorin, për ndërmarrjen apo për Agjencinë. Administratori i njofton kreditorët lidhur me hollësitë për ndryshimet thelbësore në planin për riorganizim para takimit të parë të kreditorëve.

Neni 21

Plani alternativ për riorganizim

21.1 Cilido kreditor i kualifikuar ka të drejtë t'ia dorëzojë administratorit një plan alternativ për riorganizim. Plani alternativ për riorganizim përmban informata si ato të parashtruara në nenin 20 të kësaj Rregulloreje dhe formulimet e bëra në planin alternativ për riorganizim i nënshtrohen dispozitave të njëjta për ndryshime dhe njoftimit sikurse plani për riorganizim. Ndryshimet e formulimeve të tilla nuk shkaktojnë ndonjë detyrim për kreditorin e kualifikuar.

21.2 Kreditori i kualifikuar duhet ta njoftojë me shkrim administratorin brenda tre (3) muajve prej datës së emërimit lidhur me synimin për ta dorëzuar një plan alternativ për riorganizim. Në çdo rast, kreditori i kualifikuar ia dorëzon administratorit një kopje të planit alternativ për riorganizim jo më vonë se katër (4) javë para takimit fillestarë të kreditorëve së bashku me dëshminë e duhur për statusin e tij si kreditor i kualifikuar.

21.3 Administratori i merr të gjithë hapat e arsyeshëm për të vlerësuar dhe për të njoftuar çdo kreditor të kualifikuar për datën e parashikuar të takimit të parë të kreditorëve në mënyrë që cilido kreditor i kualifikuar i cili e ka njoftuar administratorin për qëllimin e tij që ta dorëzojë një plan alternativ për riorganizim, të veprojë në pajtim me afatin kohor për dorëzimin e një kopjeje të planit alternativ për riorganizim që kreditorët ta shqyrtojnë.

21.4 Të gjitha shpenzimet lidhur me formulimin dhe dorëzimin e ndonjë plani alternativ për riorganizim paguhen nga kreditorët e kualifikuar të cilët e përgatisin një plan të tillë.

Neni 22

Njoftimi mbi planin për riorganizim

22.1 Brenda gjashtë (6) muajve prej datës së emërimit të tij, administratori e njofton Agjencinë dhe kreditorët e ndërmarrjes mbi hollësitë e kërkesës dhe të adresës që janë të njohura për administratorin, dhe çdo person i cili e ka regjistruar dëshminë e kërkesës sipas nenit 17 e njofton për datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit të parë që do të mbahet për kreditorët e ndërmarrjes (takimi i parë i kreditorëve) dhe atyre personave u dërgon:

- (a) një kopje të planit për riorganizim;
- (b) një kopje të planit alternativ për riorganizim të cilin e ka marrë ai dhe i cili i plotëson kushtet e paraqitura në nenin 21 të kësaj Rregulloreje, të përgatitura nga kreditori i kualifikuar në pajtim me nenin 17 dhe të pranuar nga administratori;
- (c) një formular votimi me autorizim së bashku me përshkrimin për ushtrimin e të drejtës për të votuar me autorizim;
- (d) një ftesë për të marrë pjesë në takimin e parë të kreditorëve përfshirë kërkesën për dorëzimin e dëshmisë së kërkesës nëse në kohën e kërkesës asnjë dëshmi e tillë nuk është dorëzuar dhe
- (e) një deklaratë me të cilën këshillohen kreditorët që mosdorëzimi i dëshmisë së kërkesës së paku pesë (5) ditë pune para takimit të parë të kreditorëve do të ketë për pasojë pamundësimin e kreditorit të votojë në takimin e parë të kreditorëve;

Me kusht që në bazë të kërkesës së administratorit gjykata të mund të urdhërojë të zgjatet periudha kohore për shpërndarjen e dokumenteve të tilla. Çdo zgjatje e tillë nga ana e gjykatës nuk i kalon tetë (8) muaj nga data e emërimit.

22.2 Njëkohësisht me njoftimin sipas paragrafit 1 më sipër administratori, në pajtim me dispozitat e nenit 49, e shpall njoftimin publik në të cilin theksohet që dokumentet e përmendura në këtë njoftim do t'i ofrohen pa pagesë cilitdo kreditor për të cilin administratori nuk është i informuar dhe i cili ia bën një kërkesë me shkrim administratorit para afatit të fundit të arsyeshëm kohor të caktuar nga administratori. Afati i tillë i fundit nuk është më tepër se dy (2) javë para takimit të parë të kreditorëve.

Neni 23

Takimi i parë i kreditorëve

23.1 Data për mbajtjen e takimit të parë të kreditorëve e caktuar nga administratori nuk është më herët se një (1) muaj dhe më vonë se dy (2) muaj pas dërgimit të planit për riorganizim në pajtim me nenin 22 të kësaj Rregulloreje.

23.2 Takimin e parë të kreditorëve e kryeson administratori dhe mbahet në ditë pune, fillon gjatë orarit të zakonshëm të punës, në një vend brenda Kosovës i cili është i përshtatshëm për administratorin dhe kreditorët e regjistruar.

23.3 Në bazë të kërkesës së administratorit për zgjatjen e afatit kohor derisa të mbahet takimi i parë i kreditorëve gjykata mund ta zgjasë afatin e tillë kohor, me kusht që periudha e përgjithshme e kohës derisa të mbahet takimi i parë i kreditorëve nuk i kalon tre (3) muaj pas datës së dërgimit të planit për riorganizim.

Neni 24

Pjesëmarrja, votimi dhe aktivitetet e takimit

24.1 Kreditori i ndërmarrjes i cili e ka dorëzuar dëshminë e kërkesës së paku pesë (5) ditë të punës para takimit të parë të kreditorëve të pranuar në mënyrë të arsyeshme nga administratori, si kërkesë e mjaftueshme dhe informatë e kreditorit (kreditorit të regjistruar), përfaqësuesit e Agjencisë kanë të drejtë të marrin pjesë në takimin e parë të kreditorëve.

24.2 Kreditorët me kërkesa të cilat administratori me arsye mund t'i përcaktojë se nuk bëjnë pjesë në afatin e parashkrimit sipas ligjit në fuqi ose të cilat nuk janë paraqitur në mënyrë të duhur në gjykatën kompetente, përfshirë edhe gjykatën sipas nevojës, brenda afatit të parashkrimit nuk konsiderohen kreditorë të regjistruar dhe nuk kanë të drejtë të votojnë.

24.3 Takimi i parë i kreditorëve ua mundëson të gjithë kreditorëve të regjistruar të ndërmarrjes:

(a) të diskutojnë, shqyrtojnë dhe votojnë planin për riorganizim të propozuar nga administratori;

(b) në rast të dorëzimit të ndonjë plani alternativ për riorganizim, të shqyrtojnë përmbajtjen e të gjitha planeve të dorëzuara dhe të vendosin me votim lidhur me planin që do të parapëlqehet më shumë në takimin e parë të kreditorëve, me kusht që kreditorët e regjistruar të votojnë për secilin plan të dorëzuar;

(c) të ngrisin dhe të diskutojnë çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e ndërmarrjes dhe

(d) të themelojnë komisionin e kreditorëve dhe të vendosin me anë të votimit për anëtarësinë e tij.

24.4 Kreditori i regjistruar i cili nuk është në gjendje të marrë pjesë personalisht në takimin e parë të kreditorëve lejohet të votojë me autorizim ose me njoftim përmes faksit, përmes dorëzimit me dorë apo përmes postës në adresën e shënuar në ftesën

për takim. Agjencia ose administratori mund të emërohen si përfaqësues të kreditorit të regjistruar.

Neni 25 Votimi në mbledhje

25.1 Të gjithë formularët dhe votat e autorizuara nënshkruhen nga kreditori i regjistruar ose nga personi i autorizuar sipas rregullit nga kreditori i regjistruar. Çdo formular ose votë e autorizuar që nuk është pranuar nga administratori së paku pesë (5) ditë pune para takimit të parë të kreditorëve është i pavlefshëm.

25.2 Në rastin kur një apo më shumë plane alternative për riorganizim paraqiten para takimit të parë të kreditorëve, administratori i regjistron votat që janë për dhe kundër secilit prej planeve në bazë të:

(i) fillimisht vlerës së votave, me kusht që vlera e secilës votë të llogaritet sipas vlerës së kërkesës të dorëzuar në dëshminë e kërkesës nga kreditori i regjistruar duke e marrë parasysh reduktimin e bërë në mënyrë të arsyeshme nga administratori dhe

(ii) pas kësaj, numrit të votave nga kreditorët e regjistruar.

25.3 Vlera e secilës kërkesë për qëllime të votimit është kalkulimi i arsyeshëm i administratorit në pajtim me nenin 33 të kësaj Rregulloreje. Administratori mund ta zvogëlojë ose ndryshojë shumën e ndonjë kërkesë të dorëzuar në dëshminë e kërkesës për qëllime të votimit nëse me arsye mendon se kërkesa e tillë nuk e paraqet vlerën e vërtetë dhe të pranueshme të kërkesës së tillë pasi janë marrë parasysh të gjitha dëshmitë në dispozicion të administratrorit dhe administratori e njofton kreditorin për ndonjë vendim të tillë me shpejtësi të arsyeshme sipas të gjitha rrethanave.

25.4 Çdo person i ndikuar nga një vendim i administratorit në pajtim me këtë nen mund të bëjë kërkesë në gjykatë për ta kundërshtuar mendimin e administratorit, me kusht që kërkesa e tillë të bëhet brenda pesë (5) ditëve të punës prej datës kur pranohet njoftimi për vendimin e administratorit. Gjykata e refuzon vendimin e administratorit vetëm nëse administratori qartazi ka vepruar në mënyrë të paarsyeshme.

25.5 Vota e kreditorit me kërkesë të siguruar llogaritet plotësisht me vlerën e kërkesës së siguruar, varësisht nga dispozitat e nenit 34 të kësaj Rregulloreje.

25.6 Për t'iu shmangur dyshimit çfarëdo vendimi i marrë nga administratori lidhur me pranimin ose me refuzimin e kreditorit të mundshëm si kreditor i regjistruar ose me zvogëlimin e vlerës së kërkesës si kreditor i regjistruar me qëllim të përcaktimit të pjesëmarrjes ose të të drejtave të votimit në takimin e parë të kreditorëve, bëhet pa e paragjykuar të drejtën e administratorit për ta pranuar ose refuzuar kërkesën e njëjtë ose për ta bërë një vlerësim ndryshe për vlerën e kërkesës me qëllim të marrjes së përfitimeve sipas planit të vërtetuar për riorganizim.

Neni 26 Shtyrja dhe mbledhjet tjera

26.1 Administratori mund të thërrasë mbledhje të tilla të tjera të kreditorëve kohë pas kohe, varësisht si e konsideron të përshtatshme për t'i shqyrtuar dëshirat e kreditorëve të ndërmarrjes, dhe takimet e tilla thirren përmes një njoftimi të arsyeshëm me shkrim për të gjithë kreditorët për të cilët ka njohuri administratori dhe kjo mbledhje mbahet në pajtim me dispozitën për takimin e parë të kreditorëve në nenin 23.2.

26.2 Administratori mund ta shtyjë takimin e parë të kreditorëve dhe çdo takim pasues të kreditorëve deri në njëzet e një (21) ditë dhe jo më shumë se në dy (2) raste. Administratori nuk është i obliguar t'i njoftojë kreditorët për shtyrjet e tilla të takimeve. Për çdo takim të shtyrë veprohet në pajtim me dispozitat e nenit 23.2.

Neni 27

Vërtetimi i planit nga gjykata

27.1 Administratori ja dorëzon gjykatës një kopje të planit për riorganizim dhe ndonjë plan alternativ për riorganizim për të cilin është votuar në takimin e parë të kreditorëve jo më vonë se një (1) muaj pas përfundimit të takimit të parë të kreditorëve dhe bën kërkesë për seancë shqyrtimi lidhur me këto plane. Gjkata e cakton një seancë të tillë shqyrtimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës prej marrjes së kërkesës të tillë.

27.2 Para ose gjatë seancës së shqyrtimit administratori mund të parashtrojë ndryshime të arsyetuara me shkrim për planin për riorganizim dhe për ndonjë plan alternativ për riorganizim në të cilat pasqyrohen çështjet e ngritura gjatë takimit të parë të kreditorëve ose të ngritura nga komisioni i kreditorëve. Si rezultat i seancës së shqyrtimit, gjykata krijon mendimin për planin për riorganizim dhe për ndonjë plan alternativ për riorganizim që është dorëzuar.

27.3 Gjkata e përpilon një urdhër për të gjitha planet e dorëzuara brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data e seancës së shqyrtimit. Në atë urdhër merren parasysh si vijon:

- (a) votimi i kreditorëve të regjistruar gjatë takimit të parë të kreditorëve;
- (b) këndvështrimet e Agjencisë dhe të administratorit;
- (c) shkalla në të cilën riorganizimi i ndërmarrjes duke u bazuar në ndonjë plan të dorëzuar do të arrijë kompensim më të madh për kreditorët sesa likuidimi i ndërmarrjes dhe
- (d) shkalla në të cilën një plan do ta arrijë ruajtjen e punësimit për të punësuarit aktual të ndërmarrjes.

27.4 Gjkata mund ta përpilojë një urdhër të tillë sipas nevojës, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në:

- (a) miratimin e një plani ashtu siç është hartuar apo me ndryshimet e bëra nga administratori, nga komisioni i kreditorëve apo me iniciativë të vetë gjykatës;

(b) refuzimin e planit për riorganizim dhe të ndonjë plani alternativ për riorganizim dhe kërkimin e një plani të korrigjuar për riorganizim nga administratori brenda një periudhe të caktuar kohore ose

(c) refuzimin e planit për riorganizim ose të ndonjë plani alternativ për riorganizim dhe kërkesa që Agjencia ta paraqesë ndërmarrjen për likuidim në pajtim me nenin 43.

Neni 28

Ndikimet e planit të vërtetuar për riorganizim

28.1 Prej ditës kur gjykata e nxjerrë urdhrin me të cilin përcaktohet plani për riorganizimin e një ndërmarrjeje dhe ndonjë ndryshimi të tij (plani i vërtetuar për riorganizim), të gjitha kërkesat dhe të drejtat e kreditorëve dhe të palëve të tjera të interesuara dhe detyrimet e ndërmarrjes ashtu siç janë saktësuar në planin e vërtetuar për riorganizim riformulohen dhe trajtohen sipas kushteve të theksuara brenda planit të vërtetuar për riorganizim. Kjo nuk ndikon në kompetencat e administratorit që më vonë të mos e shqyrtojë kërkesën sipas nenit 33 të kësaj Rregulloreje ose ta bëjë vlerësimin përfundimtar të kërkesave në pajtim me nenin 31 të kësaj Rregulloreje.

28.2 Asnjë veprim i ndërmarrjes nuk është në kundërshtim me planin e vërtetuar për riorganizim. Menaxhmenti i ndërmarrjes i ndërmerr të gjitha masat e parashtruara në planin e vërtetuar për riorganizim dhe cilado masë e ndërmarrë nga menaxhmenti është në përputhje dhe në pajtim me dispozitat përkatëse të planit të vërtetuar për riorganizim. Administratori e mbikëqyr pajtueshmërinë me dispozitat e planit të vërtetuar.

28.3 Cilado pasuri, ashtu siç është përkufizuar në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të datës 13 maj 2003 mbi transformimin e të drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtëshme shoqërore, e cila i bartet palës së tretë sipas planit të vërtetuar për riorganizim transformohet në pronë të dhënë me qira në pajtim me nenin 2 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 kur të bëhet bartja e tillë.

Neni 29

Shkelja e planit të verifikuar për riorganizim

29.1 Kreditori ose pala tjetër e prekur nga mosrespektimi thelbësor i dispozitave të planit të vërtetuar për riorganizim nga ana e ndërmarrjes, mund të njoftojë gjykatën për shkeljen thelbësore të planit të vërtetuar për riorganizim. Gjykata ia dorëzon një kopje të njoftimit ndërmarrjes, administratorit dhe Agjencisë brenda pesë (5) ditëve të punës prej pranimit të kërkesës dhe e cakton seancën e shqyrtimit lidhur me çështjen jo më vonë se dhjetë (10) ditë të punës pas ditës kur kopja e njoftimit është dorëzuar nga gjykata.

29.2 Në rastin kur gjykata zbulon se ka pasur shkelje thelbësore të planit të verifikuar për riorganizim, ajo sipas nevojës lëshon fleturdhëresën, duke përfshirë si vijon:

(a) udhëzimin që shkelja të rregullohet brenda periudhës kohore të saktësuar nga gjykata dhe nëse nuk e bën këtë ndërmarrja mund t'iu nënshtrohet procedurave të likuidimit;

(b) dhënien e urdhrin për përfundimin e procedurës së riorganizimit dhe udhëzimin e ndërmarrjes që t'iu nënshtrohet procedurave të likuidimit në pajtim me nenin 43;

(c) lejimin e ndërmarrjes ose të Agjencisë t'i dorëzojnë ndryshimet për planin e vërtetuar për riorganizim i cili shqyrtohet më tej nga gjykata ose

(d) nxjerrjen e ndonjë vendimi tjetër për ta rregulluar shkeljen i cili është në përputhje me këtë Rregullore dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

PJESA V **KËRKESAT, PRIORITETET, SHPËRNDARJA**

Neni 30

Njoftimi i kreditorëve dhe data e skadimit të kërkesës

30.1 Brenda pesë (5) ditëve të punës prej datës kur gjykata e ka përcaktuar planin e vërtetuar për riorganizim, administratori e publikon një njoftim në pajtim me dispozitën për njoftim sipas nenit 49 të kësaj Rregulloreje me të cilin i informon të gjithë kreditorët për urdhrin e tillë të gjykatës dhe për datën në të cilën gjykata e ka nxjerrë urdhrin.

30.2 Në njoftimin e publikuar administratori do të:

(a) kërkojë dorëzimin e dëshmime të tjera për kërkesën brenda tre (3) muajsh nga data kur gjykata përcaktoi planin e vërtetuar për riorganizim (data e fundit për dorëzimin e kërkesës) nga ata kreditorë ose parashtrues kërkesash, të cilët ende nuk kanë parashtruar dëshmi të kërkesës apo kanë parashtruar detaje të pamjaftueshme në raport me dëshminë e kërkesës;

(b) këshillojë të gjithë kreditorët dhe parashtruesit e mundshëm të kërkesës se mosparashtrimi i dëshmisë së kërkesës në apo para datës së fundit për dorëzimin e kërkesës do të rezultojë në pamundësimin e këtyre kreditorëve dhe parashtruesve të kërkesave për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga plani i vërtetuar i riorganizimit si dhe në shlyerjen e kërkesave në pajtim me nenin 42 të kësaj Rregulloreje.

30.3 Nëse kreditori ofron arsyetim të mjaftueshëm për parashtrim të vonuar administratori, duke përdorur diskrecionin e vet, mund të pranojë kërkesën e dorëzuar pas afatit për dorëzimin e kërkesave, me kusht që ndërmarrja të ketë fonde të mjaftueshme për përmbushjen e një kërkesë të tillë shtesë për llojin përkatës të kreditorëve.

Neni 31
Regjistrimi dhe vlerësimi i kërkesave

31.1 Menjëherë pas datës së fundit për dorëzimin e kërkesave, administratori do të vlerësojë vlefshmërinë, përmasat dhe prioritetin e kërkesave dhe çfarëdo garancie përkatëse të qartë apo hipotekë të regjistruar të paraqitur kundër ndërmarrjes me këto kushte:

(a) kërkesat që bien jashtë afatit të parashkrimit sipas ligjit në fuqi ose ato të cilat nuk janë bërë si duhet në gjykatën kompetente, përfshirë aty ku është e nevojshme edhe në gjykatë brenda afatit të parashkrimit, nuk do të kenë të drejtë të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga plani i vërtetuar për riorganizim dhe

(b) pengjet dhe hipotekat do të jenë të vlefshme vetëm nëse janë ligjërish të vërtetuara apo të regjistruara në pajtim me ligjin në fuqi.

31.2 Administratori mund të kërkojë informata dhe dëshmi të këtylla plotësuese sipas nevojës për ta bërë vlerësimin.

31.3 Një regjistër i kërkesave do të mbahet nga administratori dhe do t'i vëhet në dispozicion për inspektim ndërmarrjes, çdo kreditori të regjistruar, Agjencisë apo cilëndo palë tjetër që mund të ketë interes të drejtpërdrejtë financiar në ndërmarrjen dhe në planin e vërtetuar për riorganizim. Përgatitjet e duhura do të bëhen për secilin kreditor të regjistruar, për Agjencinë apo për cilëndo palë që mund të ketë interes të drejtpërdrejtë financiar në ndërmarrjen dhe në planin e vërtetuar për riorganizimit për ta shikuar apo për ta fotokopjuar regjistrin gjatë orarit të rëndomtë të punës.

31.4 Nëse Administratori hedh poshtë, në tërësi apo pjesërisht, ose shkurton një pjesë të kërkesës së dorëzuar, ai do ta njoftojë me shkrim sa më shpejtë që të jetë e mundur kreditorin e prekur, duke dhënë sqarimin për refuzim ose shkurtime të kërkesës.

(a) kreditori i prekur ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës brenda njëzet (20) ditë pune nga dërgimi i një kërkesë të tillë nga Administratori për përcaktimin e kërkesës së tij dhe në rast të mosparashkrimit të tillë, kreditorit do t'i pamundësohet refuzimi i mëtejshëm i vendimit të administratorit. Kërkesat e parashtruara pas kësaj periudhe njëzetditëshe (20) të punës do të pranohen vetëm nëse parashtruesi i kërkesës dëshmon se ai e parashtruar kërkesën brenda periudhës së kërkuar. Kërkesat e parashtruara më shumë se dyzet (40) ditë pune pas dërgimit të njoftimit nga ana e administratorit nuk do të pranohen.

(b) Gjykata e cakton seancën dëgjimore jo më vonë se dhjetë (10) ditë pune pas dorëzimit të kërkesës nga kreditori i prekur dhe do të përcaktohet për kërkesën jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas dëgjimit.

Neni 32
Kërkesat e pavlefshme dhe të parregullta

32.1 Administratori mund të hudhë poshtë çfarëdo kërkesë apo detyrim që del nga ndonjë transaksion në qoftë se:

(a) dokumentacioni për detyrimin i paraqitur nga ndërmarrja apo dëshmia e kërkesës e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës mbetet e paplotësuar pas kërkesës së administratorit për dokumente shtesë ose

(b) dokumentacioni i paraqitur është i rrejshëm apo ka arsye të dyshohet në qëllimin e mashtrimit të ndërmarrjes ose kreditorëve të tjerë apo

(c) ka arsye të besohet se transaksioni:

(i) nuk është miratuar përmes procedurave të rregullta të

brendshme të ndërmarrjes,

(ii) nuk do të miratohej po të ishte dorëzuar për një miratim të rregullt të brendshëm, përfshirë këtu jo vetëm kontratat, të cilat është dashur të miratohen nga ana e menaxhmentit apo zyrtarit të ndërmarrjes në kohën përkatëse por nuk janë miratuar apo

(iii) është bërë në kohën përkatëse në kundërshtim me detyrën e fiduciarit ndaj ndërmarrjes nga ana e menaxhmentit ose zyrtarit sipas ligjit në fuqi.

(iv) ka shkelur rregulloret e KB-së ose rregulloret e Këshillit të Bashkimit Evropian,

dhe në secilin rast:

(i) kreditori ka ditur apo me një kujdesi të arsyeshëm është dashur të dijë për një shkelje apo

(ii) në kohën kur është bërë transaksioni, menaxhmenti a zyrtari ka ditur apo me arsye është dashur të dijë se ndërmarrja ka falimentuar dhe se transaksioni ka rezultuar në vënien e kreditorit në pozitë më të volitshme se kreditorët e tjerë apo

(d) ka arsye të besohet se transaksioni është bërë:

(i) në një vlerë më të vogël sesa vlera e tregut a vlera e hapur apo

(ii) pagesa ose furnizimi në lidhje me transaksionin ka qenë në kundërshtim me një apo më shumë rezoluta të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose të rregulloreve të Bashkimit Evropian duke vendosur sanksione ndërkombëtare apo

(e) kërkesa i referohet një transaksionin të bërë jashtë Kosovës dhe që ka të bëjë me atë që në kohën e planit të vërtetuar për riorganizimit ka qenë një entitet ose entitet i supozuar a njësi biznesi, e cila në kohën e planit të vërtetuar të riorganizimit është menaxhuar në mënyrë të pavarur nga ndërmarrja në Kosovë dhe

administratori ka përcaktuar se nuk është praktike që në emër të ndërmarrjes të konfiskohet prona apo pasuria e një entiteti të tillë. Çdo transaksion i tillë i mbyllur në emër të ndërmarrjes do të përfshijë transaksionet për të cilat qëllimi i biznesit është kufizuar në entitetin e pavarur apo njësinë e biznesit.

32.2 Sipas këtij neni kreditori i një kërkesë të tillë mund të kundërshtojë çdo vendim të administratorit pranë gjykatë në pajtim me dispozitën e nenit 31.4.

Neni 33

Kalkulimi dhe kompensimi i kërkesave

33.1 Dispozitat e këtij neni shfuqizojnë çdo dispozitë kundërthënëse në kontratë, në ujdë, në marrëveshje, në vendim apo në ndonjë rregullim tjetër autoritativ të bërë nga ndërmarrja, në emër të saj apo në lidhje me të.

33.2 Kërkesat për para të cilat janë të shprehura në valutë të ndryshme prej euros, do të konvertohen në euro duke përdorur shkallën e këmbimit të datës së vendimit të moratoriumit. Kërkesat për para të shprehura në valuta që më nuk ekzistojnë apo janë zëvendësuar nga valuta të tjera në datën kur është lëshuar vendimi i moratoriumit apo më herët do të konvertohen në valutën apo valutat pasardhëse duke përdorur shkallën e duhur të këmbimit në kohën kur valuta ose valutat e tilla janë ndërruar dhe pas kësaj do të konvertohen në euro duke përdorur shkallën e këmbimit në fuqi të datës kur është lëshuar vendimi i moratoriumit.

33.3 Të gjitha kërkesat e bëra kundër ndërmarrjes mund të përfshijnë:

(a) shpenzimet e procedurave detyruese civile dhe ligjore deri në datën e vendimit të moratoriumit. Këto shpenzime kërkohet të identifikohen me dëshmi të duhura, që konsiderohen të arsyeshme nga administratori, të arsyetuara sipas ligjit në fuqi dhe nuk duhet të kalojnë 15% të vlerës së kërkesës dhe

(b) kamatën në shumën fillestare prej datës kur është paguar deri në datën e vendimit të moratoriumit, me kusht që një kamatë e tillë të mos kalojë 10% (dhjetë përqindëshin) e shumës fillestare.

33.4 Administratori poashtu ka të drejtë që të:

(a) shndërrojë çfarëdo kërkesë për përmbushjen specifike të një kontrate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në kërkesë për shpërndarjen e të mirave në kërkesë për dëme monetare;

(b) zvogëlojë çfarëdo kërkesë deri në atë masë që përndryshe kërkesa të jetë e kënaqshme, përfshirë edhe përdorimin e ndonjë prone apo pasurie të ndërmarrjes dhe

(c) zbërthen çdo shumë që ka ardhur për t'u paguar me kërkesë të ndërmarrjes në raport me cilëndo shumë që ka ardhur për t'u paguar sipas kërkesës ndaj ndërmarrjes, me kusht që:

(i) ndërmjet palëve ka pasur marrëveshje reciproke;
(ii) shumat e paguara përbëjnë shumat e likuiduara;
(iii) shumat e paguara nuk kanë buruar nga ngarkimi apo transferi tjetër si rezultat i çfarëdo transaksioni që është bërë brenda tre (3) muajsh para datës së vendimit për moratorium dhe

(iv) shumat e të dy kërkesave të jenë paguar para datës së vendimit për moratorium.

Neni 34 Kërkesat e siguruar

34.1 Çfarëdo kërkesë e siguruar nga një ngarkesë, siç është sekuestrimi i ligjshëm si garanci pagese, pengu, pagesa, hipoteka apo siguri tjetër mbi çdo pronë apo pasuri të ndërmarrjes (kërkesë e siguruar) nuk do ta pengojë administratorin të heqë dorë a të ushtrojë autoritetin e tij apo ta pengojë personin e tretë nga marrja e një prone o pasurie të tillë të pangarkuar dhe pa kurrfarë sigurimi me kusht që:

(a) për çdo heqje dorë apo ushtrim të autoritetit të administratorit, administratori t'i drejtohet gjykatës dhe të mund të kërkojë që heqja dorë e propozuar apo ushtrimi i autoritetit të administratorit të përfshihet në planin për riorganizim dhe

(b) Gjykata është e kënaqur që heqja dorë apo ushtrimi i autoritetit të administratorit mbi pronën a pasurinë në ngarkim është e nevojshme për mbështetjen e zbatimit efikas të planit të vërtetuar për riorganizim.

34.2 Nëse nga prona apo pasuria në ngarkim hiqet dorë apo ajo i nënshtrohet ushtrimit të autoritetit të administratorit, kërkesa e siguruar e kreditorit do të ketë prioritet të njëjtë siç do të kishte pasur sa u përket pronës dhe pasurive të tilla që do t'u nënshtroheshin heqjes dorë apo ushtrimit të autoritetit të administratorit, po qe se administratori do t'i ndërmerre këto veprime thjeshtë për krijimin e të ardhurave për t'u shpërndarë kreditorëve.

34.3 Në rast se heqja dorë apo ushtrimi i autoritetit të administratorit mbi pronën dhe pasurinë në ngarkim ka krijuar, apo vlerësohet të krijojë fonde likuide që nuk janë të mjaftueshme të sigurojnë plotësisht kërkesën e siguruar, pjesa e mbetur e kërkesës së siguruar apo që vlerësohet se do të mbetet e pasiguar konsiderohet si kërkesë e pasiguar.

Neni 35 Lista e kërkesave përfundimtare

35.1 Jo më vonë se tre (3) muaj pas vlerësimit të të gjitha kërkesave, duke përfshirë edhe përcaktimin e vërejtjeve kundër vendimit të administratorit nga ana e kreditorit të prekur lidhur me refuzimin apo zvogëlimin e kërkesave në pajtim me nenin 31, administratori harton dhe i dorëzon gjykatës listën përfundimtare të kërkesave, duke treguar sasinë dhe statusin e tyre në pajtim me kategoritë prioritare të cekura në nenin 36 të kësaj Rregulloreje.

35.2 Një kopje e listës përfundimtare të kërkesave i dërgohet ndërmarrjes, Agjencisë dhe Komisionit të kreditorëve.

Neni 36 Prioritetet e kërkesave

36.1 Kërkesat e kreditorëve klasifikohen në klasa prej (a) deri në (e) dhe do të plotësohen sipas renditjes vijuese:

- (a) Kërkesat prioritare, sipas renditjes vijuese:
 - (i) Kredia e siguruar e marrë në pajtim me nenin 13.2 në atë masë që kërkesat e tilla ndërlidhen vetëm me realizimet e pasurive, të cilat siguronin kredinë;
 - (ii) Pagesat dhe shpenzimet e administratorit, pagesat e bëra nga Qeveria, nga kreditori apo nga cilado palë e tretë për financimin e pagesave dhe shpenzimeve të administratorit;
 - (iii) Shpenzimet e gjykatës;
 - (iv) Shpenzimet administrative të Agjencisë, të cilat dëshmohen të jenë të lidhura drejtpërdrejt me mbështetjen e administratorit;
 - (v) Shpenzimet administrative të nevojshme për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe pasurisë së ndërmarrjes, përfshirë shpenzimet e shkaktuara nga veprimtaria e vazhdueshme e ndërmarrjes pas datës së vendimit për moratorium, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në kredinë e fituar nga administratori sipas nenit 31.1;
 - (vi) Shpenzimet e lejuara të Komisionit të kreditorëve në pajtim me nenin 19.3;
 - (vii) Kërkesat e siguruara për aq sa janë të realizuara nga pasuritë që i sigurojnë kërkesat e tilla dhe në shumën e kërkesave të këtilla të siguruara, duke përfshirë kërkesat e bazuara në vendimet me të cilat lejohet kompensimi në bazë të nenit 10.3 (të Rregullores së Dhomës së Posaçme);
- (b) Kërkesat bazuar në pronësinë mbi pasurinë specifike përfshirë pasurinë e patundshme;
- (c) Kërkesat për paga të punëtorëve, të cilët kanë mbetur të papaguar deri në datën e vendimit për moratorium, të kufizuara në pagë tremujore bruto për person;
- (d) Kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk i nënshtrohen trajtimit të prioritetit më të lartë;
- (e) Kërkesat e pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve ose partnerëve të ndërmarrjes.

36.2 Kërkesat e një klase apo rendi klasifikohen në mënyrë të barabartë pavarësisht nga koha e paraqitjes së kërkesave të tilla.

Neni 37
Plotësimi i kërkesave

37.1 Kërkesat do të plotësohen sipas prioritetit të klasës dhe rendit të përcaktuar në nenin 36 të kësaj Rregulloreje.

37.2 Plotësimi i kërkesave të cilat i takojnë një nënklase me prioritet më të ulët mund të fillojë vetëm pas shqyrtimit të plotë dhe të tërësishëm të kërkesave të klasës së mëparshme me prioritet më të lartë.

37.3 Nëse fondet janë të pamjaftueshme për t'i plotësuar të gjitha kërkesat e një klase apo të rendit të dhënë, kërkesat e asaj klase apo rendi do të plotësohen në përpjestim të shumës së secilës kërkesë.

37.4 Procedurat e pagesës apo plotësimit të kërkesave do të përcaktohen nga plani i vërtetuar për riorganizim.

Neni 38
Fondet e rezervuara

Administratori mund të veçojë fonde likuide, para apo pasuri të tjera në një fond të ndarë për ruajtje, që mbahet nga një agjent në mirëbesim, i cili është emëruar nga gjykata për plotësimin e:

- (a) kërkesave të cilat janë në kontest dhe nuk janë zgjidhur akoma nga gjykata;
- (b) kërkesave për pagesë që u nënshtrohen shpengimit, për të cilat kërkohet dorëzimi i dokumenteve, identifikimi apo kuponët, përfshirë sigurimet e konvertuara, marrëveshjet e bartësve apo instrumente të ngjashme;
- (c) shpenzimeve në të ardhmen që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e pronës apo pasurisë së caktuar të ndërmarrjes dhe
- (d) kërkesave që do të paraqiten në të ardhmen por që në kohën e datës së fundit për dorëzimin e kërkesave janë të papërcaktuara.

PJESA VI
PËRMBYLLJA E RIORGANIZIMIT

Neni 39
Raporti përfundimtar i administratorit

39.1 Pas përfundimit të planit të vërtetuar për riorganizim, administratori dorëzon raportin përfundimtar në gjykatë. Në raportin përfundimtar shënohen detajisht të gjitha çështjet me rëndësi që kanë ndodhur qëkur gjykata ka lëshuar planin e vërtetuar për riorganizim.

39.2 Duke u bazuar në raportin përfundimtar, administratori mund t'i drejtohet gjykatës për urdhërimin e mbylljes së procedurave riorganizative dhe planit të vërtetuar për riorganizim.

Neni 40

Përmbyllja e planit të vërtetuar për riorganizim

40.1 Pas pranimit të raportit përfundimtar dhe kërkesës së administratorit për mbylljen e procedurave të riorganizimit dhe të planit të vërtetuar për riorganizim, brenda dhjetë (10) ditë pune gjykata lëshon urdhër me shkrim për mbylljen e procedurave dhe të planit të vërtetuar për riorganizim, me kusht të jetë e kënaqur se janë kryer të gjitha apo janë kryer në masë të konsiderueshme kërkesat e planit të vërtetuar për riorganizim.

40.2 Në rast se fondet e ndërmarrjes janë të pamjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të kërkesave prioritare të cekura në nenin 36, dhe pas dorëzimit të kërkesës së administratorit në gjykatë në çdo fazë të procedurave të riorganizimit, , administratori mund ta dorëzojë menjëherë raportin përfundimtar dhe, pas miratimit të tij, gjykata lëshon vendim për mbylljen e procedurave duke bërë një urdhër tjetër nëse gjykata e konsideron të nevojshme.

Neni 41

Shkarkimi i administratorit

41.1 Në çdo urdhër për mbylljen e procedurave të riorganizimit dhe të planit të vërtetuar për riorganizim gjykata përfshin dispozitën për:

(a) lirim të administratorit nga çfarëdo detyre tjetër lidhur me ndërmarrjen dhe procedurat e riorganizimit, përveç detyrës për shpërndarjet përfundimtare që nuk kanë mbetur pa u kryer dhe

(b) miratimin e pagesës përfundimtare të çdo shpërblimi të papaguar dhe të shpenzimeve të administratorit.

41.2 Çfarëdo urdhri i tillë i gjykatës nuk e kufizon përgjegjësinë e administratorit për veprime apo mosveprime të paligjshme gjatë mandatit të tij si administrator.

Neni 42

Shlyerja e borxheve dhe riaftësimi i ndërmarrjes

42.1 Pas mbylljes së procedurave të riorganizimit dhe të planit të vërtetuar për riorganizim nga gjykata, të gjitha borxhet e papaguara të ndërmarrjes që janë bërë para datës së vendimit për moratorium shlyhen në bazë të ligjit dhe ndalohej çdo veprim për mbledhjen e këtyre borxheve të shlyera, përveç nëse gjykata urdhëron para mbylljes apo në urdhrin për mbyllje të procedurave të riorganizimit dhe të planit të vërtetuar për riorganizim.

42.2 Pas mbylljes së planit të vërtetuar për riorganizim, ndërmarrja konsiderohet financiarisht e riaftësuar dhe mund të vazhdojë aktivitetet afariste pa kufizim apo mbikëqyrje të mëtejshme.

PJESA VII **LIKUIDIMI**

Neni 43 **Kalimi në likuidim**

43.1 Gjykata lëshon vendim për fillimin e procedurave të likuidimit në bazë të nenit 9 të Rregullores së AKM-së dhe nenit 39.1 (c) të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2001/6 mbi organizatat e bizneseve (Rregullorja mbi organizatat e bizneseve) në rast se:

(a) nuk është caktuar asnjë administrator në ndërmarrje në pajtim me nenin 8 brenda periudhës së përcaktuar kohore përfshirë edhe çfarëdo zgjatje të afatit të ofruar nga gjykata;

(b) nuk është dorëzuar plani i riorganizimit nga administratori brenda afateve kohore të parapara në nenin 27.1 të kësaj Rregulloreje;

(c) nuk është vërtetuar plani i riorganizimit nga gjykata sipas nenit 27.4 të kësaj Rregulloreje;

(d) ndërmarrja shkel materialisht kërkesat e planit të vërtetuar për riorganizim dhe asnjë zgjidhje e kënaqshme nuk propozohet apo nuk pranohet nga gjykata sipas nenit 29 të kësaj Rregulloreje apo

(e) Agjencia a administratori kërkojnë fillimin e procedurave të likuidimit para lëshimit të planit të vërtetuar për riorganizim dhe nuk është dorëzuar asnjë plan alternativ për riorganizim

43.2 Me vendimin e gjykatës për fillimin e procedurave të likuidimit, administratori urdhërohet ta dorëzojë raportin përfundimtar sipas nenit 39.1 të kësaj Rregulloreje dhe të dorëzojë dokumentacionin e mbetur dhe lëndët tjera lidhur me procedurat e riorganizimit e të ndërmarrjes në Agjenci. Procedurat e riorganizimit shpallen të përfunduara.

43.3 Në procedurat e likuidimit të inicuar me vendimin e gjykatës zbatohen këto dispozita:

- (a) neni 9 i Rregullores së AKM-së;
- (b) neni 39.3 i Rregullores mbi organizatat e biznesit dhe
- (c) nenet 10.3, 10.4, 11, 12.3, 12.4, 15, 16, 17.3 dhe 17.5, prej 31 deri në 34, 35.1, 38, 46, 49, 50.2 dhe 50.3 dhe prej 51 deri në 57 të përfshira në këtë Rregullore, me kusht që:

- (i) funksionet e administratorit ushtrohen nga një komision i emëruar nga Agjencia (Komisioni i likuidimit), i cili ka fuqinë dhe autorizimet sikur të administratorit të përcaktuara në nenin 11 të kësaj Rregulloreje;

- (ii) referimet e çfarëdo plani, përfshirë planin e vërtetuar për riorganizim, janë referime në likuidimin e ndërmarrjes;

- (iii) referimi në vendimin për moratorium i referohet lajmërimit të dhënë nën nenin 9.3 (b) të Rregullores së AKM-së;

- (iv) referimi në gjykatë në nenin 35.1 të jetë referim në Këshillin e drejtorëve të Agjencisë;

- (v) referimet në datën e emërimit të jenë referime në datën e publikimit të parë të njoftimit në gazetë për kreditorë, sipas nenit 9.3 (b) të Rregullores së AKM-së.

- (d) Në shpalljen e njoftimit për kreditorë sipas nenit 9.3 (b) të Rregullores së AKM-së Agjencia do të:

- (i) kërkojë nga kreditorët dhe kërkuesit paraqitjen e dëshmive të kërkesës brenda dy (2) muajve pas datës së njoftimit të dytë;

- (ii) këshillojë të gjithë kreditorët dhe kërkuesit e mundshëm se në rast të mosparaqitjes së dëshmisë së kërkesës brenda dy (2) muajve pas datës së publikimit të dytë të njoftimit, kreditorët dhe kërkuesit e tillë nuk do të jenë në gjendje të përfitojnë nga shpërndarja e të ardhurave nga procedura e likuidimit. Neni 6.1 i Rregullores për Dhomën e Posaçme nuk zbatohet.

- (e) nëse kreditori ofron arsytim të mjaftueshëm për vonesën e parashtrimit, Agjencia, duke e përdorur diskrecionin e vet, mund të pranojë kërkesën e dorëzuar dy (2) muaj pas datës së publikimit të njoftimit të dytë sipas nenit 9.3 të Rregullores së AKM-së, me kusht që ndërmarrja të ketë fonde të mjaftueshme për llojin përkatës të kreditorëve në përmbushjen e një kërkesë të tillë shtesë.

43.4 Pas vendimit të Agjencisë për likuidimin e ndërmarrjes sipas nenit 9 të Rregullores së AKM-së, likuidimi bëhet në pajtim me dispozitat për procedura të likuidimit sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 44
Prioriteti i kërkesave në procedurat e likuidimit

44.1 Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve plotësohen në bazë të llojeve prej (a) deri në (g) më poshtë, sipas renditjes vijuese:

(a) Shpenzimet e shitjes apo të realizimit në mënyrë tjetër të pronës ose të pasurisë së ndërmarrjes;

(b) Kërkesat prioritaren sipas renditjes vijuese:

(i) Shpenzimet e gjykatës;

(ii) Shpenzimet e Komisioni për likuidim dhe të ndonjë këshilltari mbështetës;

(iii) Shpenzimet e Komisionit për likuidim që kërkohen për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe pasurisë së ndërmarrjes;

(iv) Shpenzimet për funksionimin e vazhduar të ndërmarrjes pas vendimit të Agjencisë ose gjykatës për fillimin e procedurës së likuidimit;

(v) Të gjitha shpenzimet e bëra gjatë ndonjë riorganizimi ose gjatë procedurës së likuidimit;

(vi) Kërkesat për kredi të siguruar e të marrë në bazë të nenit 13 gjatë çfarëdo procedure të riorganizimit sipas kësaj Rregulloreje, përveç se kërkesat e tilla mund të ndërliqhen vetëm me realizimin e atyre pasurive që kanë siguruar kredinë;

(c) Të drejtat e punëtorëve sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 të datës 9 maj 2003 mbi transformimin e së drejtës për shfrytëzimin e pronës së patundshme shoqërore (Rregullorja për shfrytëzimin e tokës) e ndryshuar kohë pas kohe;

(d) Kërkesat e siguruara për aq sa janë të realizuara nga pasuritë që sigurojnë kërkesat e tilla dhe në shumën e kërkesave të tilla të siguruara dhe kërkesat e bazuara në vendimet që lejojnë kompensim sipas nenit 10.3 të Rregullores mbi Dhomën e Posaçme;

(e) Kërkesat për pronësi të pasurive të veçanta përfshirë edhe pasurinë e patundshme;

(f) Kërkesat për pagat e punëtorëve që kanë mbetur pa u paguar deri më datën e marrjes së vendimit nga gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurës së likuidimit, që kufizohet në rrogën bruto tremujore për person;

(g) Kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk i nënshtrohen trajtimit me prioritet më të lartë;

(h) Kërkesat e pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve ose partnerëve të ndërmarrjes.

44.2 Kërkesat e të njëjtës klasë ose të njëjtit rend radhiten në mënyrë të barabartë pavarësisht nga koha kur është konstatuar ekzistimi i tyre.

44.3 Kërkesat plotësohen në bazë të prioritetit sipas klasës apo rendit të përcaktuar në këtë nen. Pagesat për plotësimin e kërkesave bëhen në pajtim me dispozitat e nenit 37.2 dhe 37.3 të kësaj Rregulloreje dhe respektohen procedurat e caktuara nga Komisioni për likuidim në pajtim me politikat financiare të Agjencisë, të përcaktuara në nenin 19 të Rregullores së AKM-së.

Neni 45

Përmbyllja e procedurave të likuidimit

45.1 Pas përfundimit të procedurës së likuidimit dhe shpërndarjes së tërë fondit të realizuar nga shitja ose nga realizimet tjera të pronës dhe pasurisë së ndërmarrjes, Komisioni për likuidim i dorëzon Agjencisë raportin përfundimtar. Raporti përfundimtar paraqet në detaje të gjitha çështjet e rëndësishme që kanë ndodhur prej se Agjencia ka marrë vendim për të filluar procedurën e likuidimit të ndërmarrjes.

45.2 Bazuar në raportin përfundimtar, Agjencia mund të kërkojë nga gjykata një urdhër për mbylljen e procedurës së likuidimit. Pas marrjes së raportit përfundimtar dhe kërkesës për mbyllje gjykata, brenda dhjetë (10) ditë pune, lëshon urdhër me shkrim për mbylljen e procedurës së likuidimit nëse sigurohet se tërë prona dhe pasuritë e ndërmarrjes janë likuiduar në masë të arsyeshme praktike dhe nëse janë paguar tërë fondet e realizuara apo kryesisht janë paguar.

45.3 Në çdo fazë të procedurës së likuidimit, në rast se mjetet e ndërmarrjes janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e cekura në nenin 44.1 (b) pikat (i) deri në (v) të kësaj Rregulloreje dhe pas kërkesës së Komisionit për likuidim në gjykatë, Komisioni për likuidim menjëherë mund të parashtrojë raportin përfundimtar dhe pas miratimit të tij, gjykata lëshon urdhër për mbylljen e procedurës së likuidimit si dhe urdhra të tjerë të tillë nëse i konsideron të arsyeshëm.

45.5 Në çdo urdhër për mbylljen e procedurave të likuidimit, gjykata përfshin një dispozitë për lirimin e Komisionit për likuidim nga çdo detyrë e mëtejshme në lidhje me ndërmarrjen dhe procedurat e likuidimit. Ekzekutimi i çfarëdo shpërndarjeje përfundimtare që nuk është zbatuar në kohën e urdhrin për mbyllje bëhet nga Agjencia.

45.6 Pas mbylljes së procedurës së likuidimit nga gjykata, ndërmarrja konsiderohet ligjërisht e shpërbërë dhe joekzistente dhe asnjë kërkesë tjetër kreditore apo pronësore nuk mund të zbatohet kundër Agjencisë ose pasurisë së ish-ndërmarrjes. Brenda pesë (5) ditësh nga mbyllja e procedurës së likuidimit, Agjencia shpall njoftimin publik në pajtim me dispozitat për shpallje në nenin 49 të kësaj Rregulloreje dhe njoftimin ia dërgon Zyrës kosovare për regjistrimin e bizneseve, Zyrës kosovare për regjistrimin e pengut, Zyrës kosovare për regjistrimin e hipotekës dhe Administratës tatimore me të cilën njofton se ndërmarrja është shpërbërë.

PJESA VIII **DISPOZITAT E NDRYSHME**

Neni 46
Udhëzimet nga gjykata

46.1 Në çdo kohë gjatë procedurës së riorganizimit, administratori ose kreditori I kualifikuar mund të kërkojë udhëzime nga gjykata lidhur me ndonjë pikë të ligjit në fuqi, përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në çështjen e përputhjes me këtë Rregullore apo interpretimin e planit të vërtetuar për riorganizim.

46.2 Administratori mund t'i referohet çështjes së tillë ligjore duke kërkuar me shkrim nga gjykata që të marrë vendim dhe gjykata të vendosë për një çështje të tillë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune.

46.3 Pas marrjes së kërkesës sipas paragrafit 1 ose 2 më lart, gjykata e njofton palën e cila drejtpërdrejt është e ndikuar nga kërkesa e tillë, dhe palës së tillë i lejon të paraqesë informacione në gjykatë brenda dy javësh nga pranimi i njoftimit.

Neni 47
Konsultimi

Administratori konsultohet rregullisht me të gjitha palët e interesuara relevante në lidhje me veprimet e rëndësishme sipas kësaj Rregulloreje. Palët e interesuara relevante përfshijnë Agjencinë, Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë, përfaqësuesit e punëtorëve të ndërmarrjes, dhënësit e koncesioneve, autoritetet rregullatore përkatëse dhe UNMIK-un.

Neni 48
Njoftimet

Agjencia dhe administratori, pas datës së emërimit të tij, e njoftojnë menjëherë Zyrën kosovare për regjistrimin e bizneseve, Zyrën kosovare për regjistrimin e pengut, Zyrën kosovare për regjistrimin e hipotekës dhe Administratën tatimore për sa vijon:

- (a) pas datës së vendimit për moratorium, për lëshimin e vendimit për moratorium;
- (b) pas datës së vërtetimit të planit për riorganizim nga gjykata, për përcaktimin e planit të vërtetuar për riorganizim dhe
- (c) për mbylljen e procedurës së riorganizimit dhe planit të vërtetuar për riorganizim.

Neni 49
Njoftimet dhe shpalljet publike

49.1 Çfarëdo njoftimi zyrtar sipas kësaj Rregulloreje do të botohet të paktën në sa vijon:

(a) në gjuhën shqipe në një gazetë shqiptare dhe në gjuhën serbe në një gazetë serbe, të dyja me tirazh të madh në Kosovë dhe

(b) në gjuhën serbe në një gazetë serbe me tirazh të madh në Serbi dhe në Mal të Zi.

49.2 Nëse e kërkon çështja dhe marrësitë të cilëve u drejtohet njoftimi publik, njoftimi i tillë botohet edhe në gjuhën angleze në ndonjë gazetë ndërkombëtare që ka gjasa t'u arrijë atyre të cilëve u është drejtuar ky njoftim.

Neni 50

Gjuhët e dokumenteve kryesore

50.1 Plani për riorganizim, ndonjë plan alternativ për riorganizim dhe raporti i administratorit duhet të shkruhen në shqip, në serbisht dhe në anglisht.

50.2 Komunikimet e standardizuara zyrtare, ftesat dhe formularët e përgatitur nga administratori duhet të përpilohen në shqip, në serbisht dhe anglisht, me kusht që nëse një person e njih shumë mirë apo ka treguar preferencë për një gjuhë, atëherë nuk do të jetë e obligueshme që atij personi t'i dërgohen komunikimet, letrat apo formularët në të tri gjuhët.

50.3 Çdo kërkesë ose komunikim me administratorin mund të bëhet në ndonjërin apo në më shumë prej gjuhëve - shqip, serbisht dhe anglisht.

Neni 51

Përgjashtimet nga ligji në fuqi

51.1 Veprimet e Agjencisë, të ndërmarrjes, të administratorit, të ofruesit të shërbimit, të Komisionit për likuidim, të nënkontraktuesve të tyre, të agjentëve, të pasardhësve apo të zëvendësuesve, të cilat ndërmerren sipas kësaj Rregulloreje, përjashtohen nga Rregullorja e ndryshuar dhe e zëvendësuar kohë pas kohe e UNMIK-ut nr. 2004/3.

51.2 Kërkesat e parashtruara në gjykatë pas datës së vendimit për moratorium kundër ndërmarrjes, administratorit ose AKM-së, përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në ankesat kundër vendimeve ose akteve të administratorit sipas kësaj Rregulloreje bëjnë përjashtim nga zbatimi i neneve 29.1 dhe 30.2 të Rregullores së AKM-së.

Neni 52

Juridiksioni

Me të gjitha seancat, kërkesat apo kërkesat për urdhëresa në lidhje me procedurat për riorganizimin apo likuidimin e një ndërmarrjeje ose të ndonjë çështjeje tjetër, sipas kësaj Rregulloreje merret gjykata.

PJESA IX
SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 53

Parashtrimi i dokumenteve të rrejshme në kërkesë

53.1 Çdo kreditor, ndërmarrja, menaxhmenti, zyrtari, pronari ose partneri i ndërmarrjes, ose çdo person që vepron në emër të ndërmarrjes, i cili me vetëdije parashtron dokumente të rrejshme a mashtruese apo pohon rrejshëm në dokumentacionin e parashtruar në procedurën sipas kësaj Rregulloreje i nënshtrohen një gjobe administrative që nuk kalon shumë prej pesëdhjetë mijë (50.000) euro për secilin rast. Nëse bëhet fjalë për ndonjë person fizik, personi i tillë mund t'u nënshtrohet edhe procedurave penale në pajtim me Kodin e Përkohshëm Penal.

53.2 Çdo person që me vetëdije parashtron kërkesë a dokument të rrejshëm apo bën deklaratë të rrejshme në një dokument të parashtruar në gjykatë gjatë procedurës sipas kësaj Rregulloreje mund t'i nënshtrohet një gjobe administrative që nuk kalon shumë prej pesëdhjetë mijë (50.000) eurosh për secilin rast. Nëse bëhet fjalë për person fizik, personi i tillë mund t'u nënshtrohet edhe procedurave penale në pajtim me Kodin e Përkohshëm Penal.

Neni 54

Keqpërdorimi dhe fshehja e pasurisë

54.1 Çdo person që vepron në cilësinë e administratorit ose që është i punësuar të punojë nën mbikëqyrjen e administratorit, të Komisionit për likuidim, të Agjencisë ose të ndërmarrjes, administratori, anëtar i Komisionit për likuidim ose ndërmarrja që me vetëdije keqpërdor, shkatërron, dëmton, vjedh në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë ndonjë dokument, pronë ose pasuri të ndërmarrjes, i nënshtrohet gjobës administrative e cila nuk kalon shumë prej njëzet e pesë mijë (25.000) euro për secilin rast. Nëse bëhet fjalë për person fizik, personi i tillë mund t'i nënshtrohet edhe ndjekjes penale në pajtim me Kodin e Përkohshëm Penal.

54.2 Çdo person që me vetëdije bart, fsheh apo nuk ia kthen ndonjë dokument, pronë apo pasuri të ndërmarrjes administratorit, Komisionit për likuidim, ndonjë personi që vepron në cilësinë e administratorit ose si përfaqësues i tij a si përfaqësues i Komisionit për likuidim ose gjykatës, për t'iu ikur proceseve ose procedurave të kësaj Rregulloreje, i nënshtrohet gjobës administrative që nuk kalon shumë prej njëzet mijë (20.000) euro për secilin rast. Nëse bëhet fjalë për person fizik, personi i tillë mund t'i nënshtrohet edhe ndjekjes penale në pajtim me Kodin e Përkohshëm Penal.

Neni 55

Përgjegjësia për keqbërjet kundër ndërmarrjes

55.1 Menaxherët dhe zyrtarët obligohen t'i kompensojnë ndërmarrjes çdo dëm material që i shkaktohet asaj si rezultat i bartjes së pronës ose pasurisë:

(a) para datës së vendimit për moratorium, me kusht që bartja e tillë të jetë për më pak se vlera reale dhe të jetë bërë në kohën kur menaxheri ose zyrtari të ketë marrë njoftimin e vërtetë apo konstruktiv se vlera e pronës dhe e pasurisë së ndërmarrjes hyn nën detyrimet e saj ose

(b) pas datës së vendimit për moratorium në rast të shkeljes së nenit 5 të kësaj Rregulloreje

55.2 Sipas këtij neni, njoftimi konstruktiv jepet në kohën kur ekziston arsyeja për të vlerësuar personalisht rrethanat që shpiejnë në njërën nga situatat e sipërme.

55.3 Me qëllim të përcaktimit të shkallës së çdo përgjegjësie të dhënë personit sipas këtij neni, gjykata shqyrton shkallën e kontrollit të atij personi mbi ndërmarrjen, sa ka qenë personi i tillë i përfshirë në menaxhimin aktual të operacioneve të ndërmarrjes dhe njohuritë e personit për rrethanat e ndërmarrjes dhe rrethana të tjera të tilla që gjykata mund t'i konsiderojë me rëndësi.

Neni 56

Mosrespektimi i kësaj Rregulloreje me vetëdije

Çdo person i cili me vetëdije nuk respekton ndonjë dispozitë të kësaj Rregulloreje mund t'i nënshtrohet gjobës administrative e cila nuk kalon shumë prej pesë mijë (5.000) euro për secilin rast.

Neni 57

Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi e cila nuk është në pajtueshmëri me të.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 21 nëntor 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

SHTOJCË

**NË DHOMËN E POSAÇME
TË GJYKATËS SUPREME
TË KOSOVËS**

Numri i rastit:

NË LIDHJE ME RASTIN E [shkruaj emrin e borxhliut]

Për:

Dhomën e Posaçme
të Gjykatës Supreme të Kosovës

1. Kërkesë [shkruaj emrin e kërkuetit] nga [shkruaj adresën e kërkuetit] (“Kërkueti”) e paraqitur sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/XX mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurive të tyre në Kosovë nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (“Rregullorja mbi riorganizimin”) për të hyrë në planin e riorganizimit sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/XX për ndërmarrjen në vijim:
 - i. [shkruaj emrin e një apo më shumë ndërmarrjeve] (“Ndërmarrja”) i i nënshtrohet juridiksionit të AKM-së në bazë të nenit 5 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2005/18.
 - ii. aktivitetet kryesore të ndërmarrjes(ve) janë [shkruaj detajet e aktiviteteve kryesore të ndërmarrjes].
2. Kërkueti beson se:
 - i. ndërmarrja nuk është në gjendje t’i përmbushë të gjitha obligimet e saj të arritura ose ajo ka obligime që e kalojnë vlerën e pasurisë së saj (sipas pikëpamjes së nenit 3 të Rregullores mbi riorganizimin);
 - ii. pranimi i kërkesës nga gjykata ka gjasë të vërtetojë planin për riorganizim sipas nenit 27 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/XX të datës XX nëntor r 2005 mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurive të tyre sipas autoritetit administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (Rregullorje mbi riorganizimin).
3. Kjo kërkesë duhet t’i dërgohet [].

Nënshkruar nga

.....

VËRTETIM

Kjo kërkesë është paraqitur në gjykatë

më datën **[shkruaj datën]**

në orën _____